



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



**UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**

**Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë**

**www.uni-gjilan.net tel: 0280390112**

**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN**

***FAKULTETI JURIDIK***

***PROGRAMI: JURIDIK I PWRGJITHSHWM***

***RIAKREDITIM***

***NIVELI: BACHELLOR (LLB)***

**RAPORT VETËVLERËSIMI**

**Shkurt 2020**



---

**Ky Raport Vetëvlerësimi është përgatitur nga stafi i Fakulteti Juridik, Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan, bazuar në Udhëzimet e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AKA).**

© 2020 Fakulteti Juridik, Universiteti i Gjilanit “KADRI ZEKA”

Adresa: Zija Shemsiu, p.n. 60000 Gjilan,

**Dekan:**

Prof.asoc.dr. Sadik Haxhiu

Email: sadik.haxhiu@uni-gjilan.net

Tel: Mob: +383 44 345 689

**Profesorë:**

1. Prof.asoc.dr. Sadik Haxhiu, bartës i programit
2. Prof.ass.dr. Dukagjin Leka, bartës i programit
3. Prof.ass.dr. Fadil Osmani, bartës i programit
4. Ass. dr.sc. Fatmire Krasniqi, bartës i programit
5. Msc. Armend Ahmeti – oda e avokatëve
6. Ass. PhD (c) Lizë Rexhepi - alumni

**Në asistim të:**

1. Prof.asoc.dr. Fejzulla Berisha
2. Prof.ass.dr. Urtak Hamiti
3. Prof.ass.dr. Liridon Dalipi
4. Ass.PhD (c) Detrinë Alishani
5. Msc. Blertë Dushica, sekretare e fakultetit



---

**TABELA E PËRMBAJTJES**



<b>1. HYRJE</b>	<b>5</b>
<b>1.1. Një vështrim i shkurtër i institucionit dhe programit në vlerësim</b>	<b>7</b>
<b>2. VLERËSIMI I PROGRAMIT</b>	<b>21</b>
<b>2.1. Misioni, objektivat dhe administrimi</b>	<b>21</b>
<b>Analiza SWOT për misionin, objektivat dhe administratën:</b>	<b>31</b>
<b>2.2. Menaxhimi i cilësisë</b> Error! Bookmark not defined.	
<b>Analiza SWOT për menaxhimin e cilësisë:</b> Bookmark not defined.	Error!
<b>2.3. Stafi akademik</b> Bookmark not defined.	Error!
<b>Analiza SWOT për stafin akademik:</b> Bookmark not defined.	Error!
<b>2.4. Përmbajtja e procesit arsimor</b> Bookmark not defined.	Error!
<b>Analiza SWOT për përmbajtjen e procesit arsimor:</b> Error! Bookmark not defined.	
<b>2.5. Studentët</b>	<b>164</b>
<b>Analiza SWOT për studentët:</b>	<b>166</b>
<b>2.6. Hulumtimi</b>	<b>168</b>
<b>Aaliza SWOT për hulumtim:</b> Bookmark not defined.	Error!
<b>2.7. Infrastruktura dhe burimet</b> Bookmark not defined.	Error!
<b>Analiza SWOT për infrastrukturën dhe burimet:</b> Error! Bookmark not defined.	



---

**3. EVOLUCIONI DHE ZHVILLIMI I KOHËVE TË FUNDIT I REGJISTRUAR  
QË NGA VLERËSIMI I MËPARSHËM (nëse ka) 198**

**4. SHTOJCAT (nëse ka)**

Error! Bookmark not defined.



## 2. LISTA E AKRONIMEVE

<i>ECTS</i>	Sistemi Europian i Transferimit të Krediteve
<i>CBA</i>	Projekti “Cilësi dhe Barazi në Arsim”
<i>FEMC</i>	Fondacioni Europian për Menaxhimin e Cilësisë
<i>ZEAL</i>	Zona Europiane e Arsimit të Lartë
<i>SJC</i>	Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë
<i>KEK</i>	Kuadri Europian i Kualifikimeve
<i>SUE</i>	Standardet dhe Udhëzimet Europiane
<i>IAL</i>	Institucionet e Arsimit të Lartë
<i>SBC</i>	Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë
<i>SSBC</i>	Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
<i>NJBSCFK</i>	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë Fakultetit Ekonomik
<i>ONS</i>	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
<i>TKP</i>	Treguesit Kyç të Perormancës
<i>KKKK</i>	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve Kosovë
<i>PBKV</i>	Planifikim, Berje, Kontroll, Veprim
<i>SC</i>	Sigurimi i Cilësisë
<i>KKZEAL</i>	Kuadri i Kualifikimeve për Zonën Europiane të Arsimit të Lartë
<i>FE</i>	Fakulteti Juridik
<i>KFE</i>	Këshilli i Fakultetit Juridik
<i>SWOT</i>	Pikat e Forta, Dobëta, Mundësitë, Sfidat
<i>UKZ</i>	Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”
<i>MASHT</i>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



### 3. HYRJE

Ky Raport Vetëvlerësimi (më tutje RVV), është përgatitur nga Fakulteti Juridik (më tutje FJ) i Universitetit Publik “KADRI ZEKA” Gjilan (më tutje UKZ) bazuar në Udhëzuesin e AKA-së për përgatitjen e RVV-ve për njësinë akademike. Qëllimi i përgatitjes së këtij raporti ka të bëjë me përgatitjet për riakreditim të programit Menaxhim dhe Ndërmarrësi, për periudhën kohore 2020 – 2025 për studime bachelor.

UKZ, për zhvillim të mëtutjeshëm të procesit mësimor udhëhiqet në bazë të dokumenteve në vijim:

- Deklaratën e Bolonjës;
- Standardet dhe Udhëzimet e Sigurimit të Cilësisë në Fushën e Arsimit të Lartë Evropian;
- Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (AESC)
- Konventa e Lisbonës;
- Ligji i Kosovës për Arsimin e Lartë;
- Statuti i Përkohshëm i Universitetit “Kadri Zeka”.
- Udhëzimet e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës.

Programi i studimit në vlerësim është në harmoni me këto dokumente strategjike:

- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021;
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021;
- Strategjinë Zhvillimore dhe Planin e Veprimit të UKZ 2017-2022;
- Hulumtimi i tregut të punës në Kosovë  
[https://ëëë.unsa.ba/sites/default/files/dodatak/2017-12/2016-higher-education-labour-market-balkans\\_en.pdf](https://ëëë.unsa.ba/sites/default/files/dodatak/2017-12/2016-higher-education-labour-market-balkans_en.pdf)

Referuar këtyre dokumenteve dhe hulumtimeve të tregut të punës në Kosovë, rezulton se mundësitë më të mëdha për punësimin e të diplomuarve janë në: gjykata, prokurori, administratw, ndwrmarrjet publike, kompanitw private, si dhe nw institucione tw pavaruar tw drejtwsisw si: Avokati, ndwrmjetwsim, noteri, ndihmw juridike falas etj., Evidentohet se një potencial të lartë të punësimit të të diplomuarve e kanë treguar institucionet e pavaruar tw drejtwsisw si nw: Avokati, ndwrmjetwsim, noteri, ndihmw juridike falas, pastaj nw ndwrmarrje private etj.

Mbi këtë bazë dhe duke mbështetur në punën profesionale të stafit të tij, FJ i UKZ paraqet këtë Raport Vetëvlerësimi për akreditimin e programit të studimit: Juridik i Pwrgjithshwm, si një orientim të tij:

- i. për përgatitjen e gjeneratave për tregun e punës, me theks të vecant në ngritjen e aftësive tw tyre nw fushwn juridike duke u mbështetur në të arritura bashkëkohore shkencore dhe aplikimin e tyre në praktike;



- ii. përgatitjen e kuadrove për të thelluar aftësitë kërkimore shkencore dhe për të avancuar në nivele më të larta të studimit.

Në përmbajtje të këtij raporti janë përfshirë rezultatet e analizave të gjera si në aspektin e kurrikulës ashtu edhe në atë nevojave të tregut dhe të shoqërisë. Prandaj raporti në vazhdim është rezultat i një debati të gjerë dhe analize të gjithanshme në funksion të përgatitjes së një programi të studimit që do të jetë në harmoni me nevojat e tregut të punës.

Raporti është përgatitur me pjesëmarrje të gjerë të stafit akademik të FE, studentëve alumni dhe përfaqësuesve të biznesit.





## 1.1 Metodologjia e përgatitjes së raportit

Struktura dhe përmbajtja e këtij raporti bazohet në Udhëzuesin të AKA-së për përgatitjen e RVV-ve. Dekanati i Fakultetit, fillimisht ka bërë Hulumtimin për Karrierën e të Diplomuarve të këtij programi, në vitin 2019. Pastaj ka pasur takime me përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë si: gjykatave, prokurorive; pastaj me përfaqësuesit e institucioneve të pavarura të drejtësisë. Në këto dy takime ka marrë pjesë edhe tre përfaqësues tjerë të stafit akademik. Ndërkohë, në organizim të Dekanatit, janë zhvilluar takime punuese me stafin e Fakultetit Juridik (dt. 03.10.2019 dhe 10.10.2019, ku është diskutuar për programet me të cilat do të aplikohet për akreditimit/riakreditim. Pas këtyre takimeve dhe punës në grupe të vogla, është mbajtur edhe takimi i fundit i përbashkët (dt. 31.01.2020 <https://www.uni-gjilan.net/lajmet/fakulteti-juridik-i-ukz-se-ka-mbajtur-takim-pune-per-pergatitjet-rreth-akreditimit-te-programeve-studimore/> nga i cili ka dale versioni final i RVV.

Mbi bazën e kësaj pune dhe analizën gjithpërfshirëse, propozimet finale, Dekani i ka paraqitur në Këshillin e Fakultetit në mbledhjen e datës 24.10.2019. Në këtë mbledhje janë miratuar si propozim programet, bartësit e tyre sipas fushave të studimit si dhe janë caktuar grupet punuese si dhe stafi ndihmës për hartimin e RVV-së. Më pas janë mbajtur edhe një varg takimesh të grupeve punuese në grupe më të vogla si dhe shtatw takime të përbashkëta (dt. 22.10.2019, dt. 07.11.2019; 30.01.2020; 16.01.2020; 30.01.2020 dhe 07.02.2020 shih dokumentet bashkëlidhur) ku fillimisht janë caktuar parimet për strukturën e programeve studimore, përkatësisht kurrikulës, pastaj është bërë dakordimi për përmbajtjen e tyre. Pas punës në grupe të vogla, ku janë ndarë detyra për hartimin e pjesëve të veçanta të RVV është mbajtur edhe takimi i fundit i përbashkët ku është harmonizuar kjo formë e RVV-së. Vlerësimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport për çështje të ndryshme, mbështeten në të dhënat ekzistuese të prezantuara në këtë raport. Po ashtu, në raport është analizuar edhe metodologjia e mësimdhënies, vlerësimit të studentëve, dizajnit dhe implementimit të ECTS kredive.



## 1.2 Vështrim i shkurtër i institucionit dhe programit në vlerësim

### *Misioni dhe objektivat , programet e studimit që ofrohen*

UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” GJILAN u themelua me vendimin e Qeverisë së Kosovës numër 118/03 të datës 6 mars 2013, i cili nga Kuvendi i Kosovës u miratua më 30 maj 2013. Ky vendim i Kuvendit të Kosovës realizoi synimin dhe punën disa dekadëshe që është bërë në Gjilan me arsimin e lartë, prej vitit 1958 kur u themelua Qendra për Aftësimin e Mësimdhënësve (shkollë për përgatitjen e mësuesve). Themelimi i UKZ-së bëri të mundur përfshirjen në shkollimin e lartë universitar të numrit më të madh të studentëve në Lindje të Kosovës, të Luginës së Preshevës, rajonit të Kumanovës nga Maqedonia Veriore si dhe të viseve të tjera. Në mbledhjen VIII të Këshillit Themelues të UKZ-së, mbajtur më 31.10.2013, u propozua që Universiteti Publik në Gjilan të ketë emrin “Kadri Zeka” dhe akronimin UKZ, propozim të cilin e ka miratuar MASHT-i më 13.11.2013.

Konform Statutit të Përkohshëm të Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan, themelimi i UKZ-së bartë idenë e promovimit dhe zhvillimit të arsimit të lartë universitar, kërkimeve shkencore, krijimtarisë artistike dhe kualifikimin e kuadrave deri në gradën e doktoraturës.

UKZ vazhdimisht punon për të krijuar cilësi të lartë, në të gjitha aktivitetet e saj, për të siguruar dhe përmirësuar kualitetin në mësim, studim dhe hulumtime shkencore, duke monitoruar dhe vlerësuar performancën e stafit akademik dhe duke krijuar kushtet e mësimnxënies për studentët.

**Vizioni ynë:** *Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan është në shërbim të dijes, të edukimit dhe të mirëqenies së shoqërisë kosovare dhe të mbarë njerëzimit.*

*Universiteti është mundësia më e mirë për një shoqëri që t'i edukojë dhe t'i bëjë të përgjegjshëm anëtarët e vet për vlerat themelore: për lirinë, parimet e demokracisë, familjen, mirëqenien ekonomike, paqen sociale dhe vlera të tjera humaniste, të cilat qëndrojnë në themel të një shoqërie me vlera të larta.*

Vizioni i UKZ, si shihet, ka pesë shtylla: dijen, edukimin, mirëqenien e shoqërisë kosovare dhe mirëqenien e shoqërisë njerëzore. Me këtë vizion UKZ i bën vetes vendin në mesin e universiteteve të botës të cilat punojnë për dijen, edukimin dhe mirëqenien e shoqërisë njerëzore. Në frymë të këtij globalizmi, vizioni i UKZ përmend edhe disa prej vlerave themelore të shoqërisë dhe kulturës moderne humaniste, si: lirinë, parimet e demokracisë, familjen, mirëqenien ekonomike, paqen sociale dhe vlera të tjera humaniste.

**Misioni i universitetit është:** *Tempull i dijes i cili kultivon dashurinë njerëzore dhe afirmon parimet e konkurrencës lojale.*

*Të përgatisë të rinj të përgjegjshëm dhe profesionalisht të aftë për të qenë pjesë e një shoqërie moderne dhe globale, pjesë e një tregu më të gjerë se sa tregjet tradicionale të punës dhe njëkohësisht, model për anëtarët e tjerë të shoqërisë sonë.*



Edhe misioni i UKZ është i orientuar kah tregjet e gjera të punës, kah konkurrenca lojale dhe kah aftësimi profesional i studentëve të vet.

Prandaj, UKZ ka rol dhe përgjegjësi të veçantë në përparimin dhe zhvillimin e pasurisë intelektuale, shkencore, artistike dhe kulturore, si dhe në forcimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit të ndërsjellë me institucionet përkatëse të botës në fushën e dijes dhe hulumtimeve shkencore.

Për këtë qëllim, UKZ ka hartuar **Strategjinë Zhvillimore dhe Planin e Veprimit 2017-2022**, e cila është miratuar nga Këshilli Drejtues në muajin maj 2017, të cilat përmbledhin punën, të arriturat, sfidat dhe synimet e së ardhmes së UKZ-së.

UKZ ofron kushte të barabarta për fitimin dhe gjenerimin e dijes, e cila reflektohet në mosdiskriminimin e askujt.

Kreativiteti i reflektuar në ide të reja dhe forma të shprehjes, kureshtja intelektuale, gatishmëria për t'u ballafaquar me rreziqe dhe frymën sipërmarrëse, reflekton në aderimin tonë me standardet më të larta etike në sjelljen personale dhe profesionale.

Në UKZ janë zhvilluar debate për ndryshimin gradual të qasjes mësimore: nga qasja klasike e memorizimit të të dhënave kah nxitja e mendimit kritik. Stafi akademik tashmë e kupton se në botën e teknologjisë informative shpjegimi klasik i profesorit në klasë e ka humbur rëndësinë, pasi studenti në cdo cast mund të ndjek të njëjtën ligjëratë nga shumë profesorë të tjerë në internet. Prandaj profesori duhet ta ndryshojë qasjen: ai duhet të nxisë studentët të mendojnë në mënyrë kritike për temat që synon t'ua shpjegojë, t'i nxisë vetë ata ta shpjegojnë dhe ta kuptojnë thelbin e temës. Në këtë mënyrë profesori shndërrohet në celës të dijes, në vend të posedues dhe shpërndarës i dijes, si ka qenë që nga koha e Humanizmit dhe Renesansës.

Angazhimi i UKZ-së për transparencën dhe llogaridhënien në qeverisje dhe në aktivitetin akademik, krijon qëndrueshmërinë e reflektuar në angazhimin tonë të përbashkët për të udhëhequr me shembull në qasjen tonë ndaj planifikimit përgjegjës akademik dhe financiar. UKZ gjithmonë kërkon përsosmëri, sepse kupton rëndësinë e të menduarit kritik, disiplinën dhe përgjegjësinë, andaj synohen dhe priten standarde të larta për insitucionin dhe studentët e UKZ-së.

Aktualisht, në kuadër të Universitetit, ofrohen 10 programe (8 programe të nivelit bachelor dhe 2 programe të nivelit master):

1. Fakulteti i Edukimit
  - Programi Parashkollor
  - Programi Fillor
2. Fakulteti Juridik
  - Juridik i Përgjithshëm
3. Fakulteti Ekonomik
  - Banka, financa dhe kontabilitet



- Marketing
- Menaxhment
- 4. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike
  - Shkencat kompjuterike
- 5. Fakulteti i Shkencave Aplikative
  - Matematikë Arsimore
- 6. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Juridik dhe Ekonomik
  - Programi Master (Interdisciplinar): e-qeverisja
- 7. UKZ, UPZ dhe UHZ
  - Programi Master (i përbashkët): Qeverisja lokale dhe shoqëria demokratike.

Në UKZ është zhvilluar një debat i gjerë për orientimin e UKZ edhe kah shkencat aplikative. Kjo ka rezultuar me formimin e Fakultetit të Shkencave Aplikative në vitin 2019 dhe me akreditimin e programit të parë aplikativ Matematika Arsimore. Në Strategjinë Zhvillimore të UKZ janë trasuar dy rrugë koherente të zhvillimit akademik të UKZ:

- Zhvillimi i programeve shkencore
- Zhvillimi i programeve aplikative.

Në zhvillimin e programeve studimore të nivelit master UKZ ka sjellë risi në arsimin e lartë në Kosovë duke zhvilluar programe të përbashkëta edhe me dy universitete publike (Universiteti i Prizrenit dhe Universiteti i Pejës) dhe duke zhvilluar programe interdisciplinare në pronësi të tri fakulteteve të UKZ (Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti Juridik).

Me tabelën në vijim paraqesim fakultetet, emërtimet e programeve dhe gradave përkatëse që fitohen pas përfundimit të studimeve në këto programe:

Nr.	Fakulteti	Programi i studimit	Niveli i studimit	Grada që fitohet
1.	Fakulteti i Edukimit	Parashkollor	BA	Bachelor i edukimit parashkollor
		Fillor	BA	Bachelor i edukimit fillor
2.	Fakulteti Juridik	Juridik i përgjithshëm	LLB	Jurist i diplomuar
3.	Fakulteti Ekonomik	Banka financiare dhe kontabilitet	BSc	Bachelor i bankave financiare dhe kontabilitetit
		Menaxhment	BSc	Bachelor i menaxhmentit
		Marketing	BSc	Bachelor i marketingut
4.	Fakulteti i Shkencave	Shkencat kompjuterike	BA	Bachelor i shkencave kompjuterike




	Kompjuterike			
5.	Fakulteti i Shkencave Aplikative	Matematikë Arsimore	BA	Bachelor i Matematikës Arsimore
6.	Fakulteti i Sh. Kompjuterike Fakulteti Juridik Fakulteti Ekonomik	E- Qeverisja	MA	Master i E- qeverisjes
7.	Universiteti i Gjilanit Universiteti i Prizrenit Universiteti i Pejës	Qeverisja lokale dhe shoqëria demokratike	MA	Master i Qeverisjes Lokale dhe Shoqërisë Demokratike



- *Udhëheqja institucionale, strukturat e menaxhimit dhe marrëveshjet e administratës dhe personelit*


Emërtimi i institucionit është: Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, akronimi: UKZ.  
 Në mbledhjen e Këshillit Drejtues të Universitetit të Gjilanit, më 01.04.2016, është aprovuar Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në UKZ. [shih shtojcën](#))  
 Organizimi i strukturave vendimmarrëse në administratën e universitetit paraqitet me anë të organogramit, si në vijim:



Organizimi i strukturave vendimmarrëse në çështjet akademike bëhet konform Statutit të Përkohshëm të Universitetit. Këshilli Drejtues merr vendime për hapjen dhe mbylljen e programeve studimore dhe njësive akademike.

Për të gjitha çështjet akademike vendos Senati i Universitetit, të cilin e kryeson rektori. Anëtarët e Senatit zgjidhen nga njësitë akademike të Universitetit, nga administrata dhe nga Parlamenti i Studentëve. Këshilli i Fakultetit propozon programin studimor të ri i cili i dërgohet Komisionit të Studimeve të Fakultetit për shqyrtim.

Këshilli i Fakultetit propozon programin studimor të ri i cili i dërgohet Komisionit të Studimeve për shqyrtim. Komisioni i Studimeve e shqyrton, e refuzon apo e propozon për miratim në Senatin e UKZ-së. Senati i UKZ-së e aprovon ose e refuzon propozimin e Këshillit të Fakultetit. Këtë mënyrë të organizimit e paraqesim në mënyrë skematike, si në vijim:



Vend të posaçëm në strukturat organizative i është kushtuar pjesëmarrjes së studentëve. Përfaqësimi i studentëve bëhet:

- në bazë të Statutit të Universitetit, dy përfaqësues të studentëve janë anëtarë me të drejtë vote të organit më të lartë të Universitetit –Senatit;
- në këshillin e Fakultetit një student me të drejtë vote;
- në Këshillin Drejtues është një anëtar – student vëzhgues;
- në Komisionin për studime (dy studentë marrin pjesë me të drejtë vote).

Për organizimin e aktiviteteve të studentëve, menaxhmenti i UKZ-së ka siguruar përkrahje të plotë, duke siguruar hapësirë të nevojshme dhe logjistikë tjetër të nevojshme.

*Procedurat për zgjedhjen e personelit*, posaçërisht procedurat për emërimet (thirrjet) për mësimdhënësit bazohen në Statutin e Universitetit (Shih Shtojca nr.1 Statuti i UKZ) dhe në <https://ëëë.uni-gjilan.net/ëp-content/uploads/2016/09/Rregullorje-p%C3%ABr-zgjedhjen-e-stafit-akademik-n%C3%AB-Universitetin-Kadri-Zeka.pdf> si dhe ajo e vitit 2019).

Procedura për zgjedhjen e personelit dhe për emërimet e mësimdhënësve është si në vijim. Pas identifikimit të nevojës për mësimdhënësit nga njësitë akademike të universitetit, me miratimin e Senatit. Rektori shpall konkurs të hapur në mjetet e informimit publik, ku përshkruhet vendi i punës dhe kushtet e nevojshme që duhet të plotësojë kandidati i cili konkurren.

Në njësinë akademike, për secilin vend të punës, formohen *komisionet recensuese* (prej 3 anëtarëve-anëtarët e komisionit duhet të kenë thirrje akademike më të lartë se ajo që kërkohet në konkurs), të cilat shqyrtojnë dokumentacionet e kandidatëve, i intervistojnë ata për të cilët konsideron se është e nevojshme dhe ua propozojnë njësisë akademike. Propozimet e Komisionit recensues shqyrtohen në *Këshillin e Fakultetit* dhe nga aty dërgohen në *Komisionin për studime* të Senatit. Komisioni për studime shqyrton aspektin akademik, rezultatet



shkencore të kandidatit, si dhe aspektet e tjera, të cilat sigurojnë cilësi në punën akademike të universitetit.

Pas kalimit në Komisionin për studime, procedura e emërimit bëhet nga *Senati i Universitetit* për periudhën 4-vjeçare për profesorë, profesorë të asocuar dhe profesorë asistentë. Për emërimin e ligjëruesve dhe asistentëve mësimorë, emërimi bëhet për periudhën 3-vjeçare. Askush nuk mund të jetë anëtar i Komisionit recensues, nëse dikush nga kandidatët që duhet të emërohet është bashkëshort, partner ose anëtar i familjes së ngushtë të tij/saj.

Shih Shtojca nr.2. Rregulloren për Zgjedhjen e stafit akademik (ref.01/1474, të datës 09.12.2015).

Emërimet e titujve për personelin akademik, bazuar në Statutin e UKZ-së, janë:

- *Prof. dr. (profesor i rregullt)*
- *Prof. Asoc. dr. (profesor i asocuar)*
- *Prof. Ass. dr. (profesor asistent)*
- *Ligj. (ligjërues)*
- *Ass. (asistent universiteti)*

Kushtet dhe mënyrat e zgjedhjes në këto thirrje janë të përcaktuara me Statutin e Universitetit (shih Shtojca nr.1).

Janë proceduar kërkesat e njësive akademike (fakulteteve) për shpalljen e konkursit për staf të rregullt akademik në fushat për të cilat mungon stafi akademik, kërkesa të cilat do të shqyrtohen nga Senati dhe të procedohen për realizim gjatë këtij viti akademik dhe të fillohet viti i ri akademik 2020/2021, me staf të mjaftueshëm dhe më të përgatitur

Ndërsa, stafi administrativ, përfshirë edhe sekretarin e përgjithshëm, ka 21 zyrtarë, të ndarë nëpër njësi të veçanta si vijon: 2 zyrtarë në rektorat; 3 zyrtarë të financave; 1 zyrtar certifikues; 2 zyrtarë të IT-së; 2 zyrtarë për çështje akademike; 1 zyrtar për diploma; 6 zyrtarë në shërbimin e studentëve, 1 bibliotekiste, 1 zyrtarë e arkivit dhe zyrtari për mësim praktik.





### SEKRETARI I PERGJITHSHEM

<i>Te shkruhen zyrat</i>	<i>Personeli i zyrës</i>
Zyra për Shkencë, Zhvillim Akademik dhe Cilësi	Drejtori Koordinatorët e cilësisë nga Fakultetet
Zyra për Buxhet dhe Financa	Drejtori 3 zyrtarë 1 zyrtar (në procedurë)
Zyra e Prokurorit	1 zyrtarë
Zyra e Çertifikimit	1 zyrtarë
Zyra për marrëdhënie me jashtë	1 zyrtarë 1 zyrtar i lartë (në procedurë)
Zyra për Çështje Akadematike	1 zyrtarë
Zyra e Personelit	Menaxheri
Zyra Ligjore	1 zyrtarë
Zyra e IT	Udhëheqësi 1 zyrtarë
Zyra e Arkivës	1 zyrtarë
Zyra e Rektorit	1 Asistente
Zyra e Sekretarit	1 Asistente
Zyra për Informim dhe Protokol	Udhëheqësi
Zyra për Shërbim të Studentëve	Udhëheqësi 5zyrtarë 1 zyrtarë në procedurë
Zyra e Koordinatorit për Mësim	1 zyrtarë
Bibloteka Universitare	1 zyrtarë

Në fushën e zhvillimit të infrastrukturës së UKZ-së në të ardhmen planifikohet të ngritet një kampus i ri universitar, modern, me gjithë infrastrukturën e nevojshme. Ky investim realizohet nga Qeveria e Kosovës.



Më 28 dhe 29 janar 2020 UKZ është takuar me Ministrinë Financave të Republikës së Kosovës dhe me Bankën Europiane për Investime dhe Bankën Zhvillimore të Këshillit të Europës për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe për ndërtimin e kampusit të ri të UKZ.

Kuvendi i Gjilanit ka paraparë vendin ku duhet të ndërtohet kampusi i ri i UKZ (shih vendimin 01.Nr.45809, Gjilan,27.05.2013) dhe Kryeministri i Kosovës ka vendosur kalimin në shërbim të UKZ të parcelës prej 7.30 hektarëve për ndërtim të kampusit të ri (shih vendimin Nr.01/19 dt.15.12.2017), por ende nuk ka një pajtim të të gjitha palëve për vendin e saktë ku do të ndërtohet kampusi. Janë dy zgjedhje:

1. Kampusi të ndërtohet në vendin e paraparë nga Kuvendi i Gjilanit dhe i vendosur nga Kryeministri i Kosovës;
2. Në vendin ku është objekti aktual i UKZ, me një objekt shtesë në anën perëndimore të tij. Ky variant i dytë e nënkupton edhe renovimin e gjithë objektit aktual të UKZ.

Gjatë vitit 2020 duhet të zgjidhet kjo çështje dhe të fillojnë punët në realizimin e kampusit të UKZ-së (Shih kwrkesen drejtuar KK te Gjilanit,Nr. 01/2517 dt.27.11.2019)

Lidhur me detajet e planit të financuar të UKZ-së, e gjeni të bashkangjitur me këtë raport buxhetin e lejuar nga MASHT për 3 vitet në vijim, (shih Shtojca– Buxheti i UKZ-së).



- *Studentët e Universitetit “Kadri Zeka”, prejardhja e tyre socio-ekonomike dhe informatat përkatëse kontekstuale rreth fushës në të cilën vepron institucioni*

Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan është i hapur për të gjithë kandidatët që plotësojnë kushtet formale për t’u regjistruar në studime universitare, në programet të cilat akreditohen nga Agjencia e Kosovës për Akreditim. Studimet zhvillohen në gjuhën shqipe. Në konkurset e rregullta për pranimin e studentëve të rinj, ftohen kandidatët të cilët kanë të kryer shkollën e mesme pa ndonjë kufizim, gjinie apo përkatësie tjetër. Numri më i madh i studentëve është nga rajoni i Gjilanit dhe Ferizajit (komunat Kamenicë, Novobërdë, Gjilan, Viti, Ferizaj, Kaçanik, Hani i Elezit, Partesh, Kllokot, Ranillug), por edhe një numër i konsiderueshëm është nga rajonet e tjera të Kosovës (sidomos në programin master *E-qeverisja*, i cili është i programi unik jo vetëm në Kosovë), si dhe nga Lugina e Preshevës (Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë) dhe nga Maqedonia Veriore (Kumanovë me rrethinë).

UKZ, pas disa takimeve që ka pasur menaxhmenti me komunat me shumicë serbe, është duke diskutuar edhe mundësinë e fillimit të programit studimor të edukimit Filllor dh Parashkollor në gjuhën serbe.

UKZ ka gjithsej **6789** studentë, në të gjitha programet e studimit nëpër njësitë akademike. Zakonisht realizohen dy konkurse për pranimin e studentëve të rinj, në korrik dhe shtator. Vendet e lira të cilat nuk plotësohen në afatin e parë (korrik), UKZ shpall konkursin e dytë (shtator) për vendet e lira për studentë të rregullt. Për vitin akademik 2019/2020 janë pranuar gjithsej **772 studentë**. Nga viti 2016 (kur kanë diplomuar studentët e parë të UKZ-së) e deri më tash kanë diplomuar gjithësej **980 studentë**.

Në afatin e parë të pranimit të studentëve plotësohen të gjitha vendet e parapara me konkurs, ndërsa në afatin e dytë të pranimit të studentëve nga minoritetet, studentët nga Lugina e Preshevës dhe për kuotat e tjera të përcaktuara nga MASHT. Interesimi më i madh i studentëve të rinj paraqitet për programet e edukimit fillor, shkencave kompjuterike mandej për juridik dhe ekonomik. Po ashtu interesim i jashtëzakonshëm i studentëve gjatë vitit të kaluar ishte për programet master *E-qeverisja dhe Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike*. Nga anketat që janë bërë me nxënës të shkollave të mesme të Gjilanit dhe rrethinë, kemi një rritje të interesimit për programe të reja të UKZ. Për këtë arsye risitë zënë vend në programet e propozuara ([Juridik i Pwrgjithshwm dhe programi master: Juridik Penal](#)) për Ri Akreditim dhe Akreditim

Në çdo konkurs për pranim të studentëve të rinj, respektohet vendimi i MASHT-it për kuotat e caktuara për minoritete të cilat jetojnë në Kosovë. Nga minoriteti turk dhe boshnjak kemi numrin më të madh të regjistruar në UKZ.

Tjetër karakteristikë është që UKZ rezervon edhe një numër të caktuar të vendeve për studentët nga Lugina e Preshevës, duke pasur parasysh që kjo popullatë, Universitetin më të afërt e ka Universitetin Publik “Kadri Zeka” në Gjilan. Vazhdimisht, në çdo konkurs për regjistrim të studentëve, kuotat e parapara për studentët nga Lugina e Preshevës regjistrohen në të gjitha



programet e studimit të UKZ-së, edhe pse organet zyrtare të Serbisë vazhdimisht u sjellin kokëçarje studentëve me diplomat e lëshuara nga Republika e Kosovës, duke i njohur me vështirësi apo edhe duke i refuzuar.

Gjithashtu pritet që për vitin e ri akademik të ketë një interesim të shtuar nga studentët e rajonit të Kumanovës pasi që rruga Kumanovë-Gjilan është lëshuar për qarkullim me hapjen e pikëkalimit kufitar në Stanciq (<https://tvklan.al/hapet-pika-kufitare-kosove-maqedoni/>).

Prejardhja socio-ekonomike e studentëve të UKZ-së ka dy karakteristika kryesore:

- Studentët e UKZ janë pothuajse të gjithë nxënës të cilat kanë kryer shkollimin e mesëm të lartë (12-vjeçar) dhe provimin e maturës (për të dy këto kualifikime merret numër i caktuar i pikëve të cilave u shtohen pikët e fituara në provimin pranues që e organizojnë fakultetet përkatëse). Nuk hetohet ndonjë dallim drastik i gjendjes ekonomike të studentëve, duke pasur parasysh që pagesa për regjistrimin e semestrave është i pranueshëm për studentët. Për studentët me gjendje të vështirë ekonomike, komunat nga të cilat vijnë ata, ndajnë rregullisht bursa për studentë. Bursa për studentët e shkëlqyeshëm ndan edhe Universiteti, sikurse edhe MASHT-i. Po ashtu edhe organizmat e tjerë, ndajnë bursa për kategori të studentëve të shkëlqyeshëm, për studentët me vështirësi ekonomike dhe të tjera. Numri më i madh i studentëve të cilët jetojnë jashtë Gjilanit, për t'i ndjekur ligjëratat dhe aktivitetet e tjera mësimore, udhëtojnë. Duke iu falënderuar pozitës së Gjilanit që është afër vendbanimeve të shumicës së studentëve dhe zhvillimit të hovshëm të kompanive të transportit publik, nuk hetohet ndonjë ngecje në këtë drejtim.
- Një numër i studentëve të cilët jetojnë më larg nga Gjilani, shfrytëzojnë konviktin e nxënësve dhe studentëve të cilin e menaxhon komuna e Gjilanit, ndërkaq çmimi i fjetjes dhe ushqimit (35 euro për një muaj) është mjaft i favorshëm në aspektin ekonomik.

Procesi mësimor në UKZ zhvillohet prej orës 9:00 deri në orën 18:00, ndërsa për studimet master vazhdon deri në ora 20:00.

#### • *Mësimdhënia, mësimi dhe kurikula*

Mësimdhënia dhe mësimnxënia në programet studimore të UKZ bazohet, fillimisht në rregulloret e aprovuara nga ana e Senatit. Gjatë hartimit dhe përgatitjes së programeve studimore, e sidomos gjatë realizimit të procesit mësimor në këto programe, rol të rëndësishëm luan stimulimi dhe motivimi i studentëve në procesin mësimor, duke ofruar një varg të aktiviteteve: ofrimi i syllabuseve të lëndëve në fillim të semestrit, ligjëratat dhe ushtrimet me metoda fleksibile dhe me material të nevojshëm, organizimi i vlerësimeve periodike dhe të vazhdueshme, përdorimi i IT-së dhe aplikacionit e-learning, konsultimet e rregullta me mësimdhënsit etj. Në matjen e performancës së mësimdhënësve dhe të procesit mësimor,



indikatorët kryesorë janë: vlerësimi i studentëve dhe rezultatet e arritura të studentëve, monitorimi i rregullte i procesit mësimor, etj.

Në ngritje të rolit mbikqyrës të procesit akademik, menaxhmenti i UKZ ka vendosur në hyrjet e UKZ regjistrimin digjital për stafin akademik dhe stafin administrativ. Regjistrin e hyrje-daljeve të stafit e kontrollojnë dekanat e fakulteteve dhe sekretari gjeneral për administratën në baza javore, ndërsa gjetjet diskutohen edhe në takimet javore të rektorit me dekanët. Mënyra e organizimit të procesit mësimor, si edhe vlerësimi i të arriturave të studentëve në studimet e programit Juridik i Pwrgjithshëm, bëhet konform Rregullores për studime Bachelor. ([https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2017/07/Rregullore\\_per\\_Studimet\\_Themelore\\_Bachelor\\_Fakulteti\\_Juridik](https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2017/07/Rregullore_per_Studimet_Themelore_Bachelor_Fakulteti_Juridik)).

Në Rregulloren e studimeve bachelor, janë përcaktuar organizimi i studimeve, kohëzgjatja e studimeve, kushtet e regjistrimit, kriteret e kalueshmërisë në vitin vijues, ndryshimin e programit të studimeve, kalimin nga/në fakultetet e tjera, organizimi i provimeve, të drejtat dhe detyrat e studentit, organizimi i studentëve, përfundimi i studimeve dhe diplomimi i studentëve etj. (shih: Rregullorja e studimeve Bachelor).

Paraqitja e provimeve bëhet gjatë tri afateve të rregullta: në afatin e janarit - prej 15 deri më 20 janar, në afatin e qershorit - prej 1 deri më 5 qershor, në afatin e shtatorit - prej 20 deri më 30 gusht.

Mësimdhënësi është i detyruar që pas përfundimit të rezultateve përfundimtare të provimit, më së largu brenda 72 orësh t'ia dorëzojë zyrtarit të shërbimit të studentëve raportin e provimeve, bashkë me listën e studentëve si dhe kopjet fizike të fletëparaqitjeve të shkarkuara nga sistemi SMU. Format e mbajtjes së provimit janë: provimi me shkrim, provimi me gojë, provimi me shkrim dhe me gojë, provimi me test, provimi praktik dhe kolokuiumi.

Vlerësimi i provimit shprehet me notë:

Nota në UKZ	Përshkrimi me fjalë	Barasvlefshme me Sistemin e Bolonjës
10	shkëlqyeshëm	A,
9	Shkëlqyeshëm	B
8	Shkumë mirë	C
7	Mirë	D
6	Mjaftueshëm	E
5	pamjaftueshëm	F



Studentët duhet të arrijnë notën minimale 6 për kalueshmëri, që do të thotë se studentët duhet të arrijnë minimum 50% të notës përfundimtare për lëndët përkatëse.

Roli vendimmarrës i studentëve në strukturat organizative të UKZ-së zhvillohet nga pjesëmarrja e tyre në organet vendimmarrëse: Bazuar në Statutin e UKZ-së, dy përfaqësues të studentëve janë anëtarë me të drejtë vote në Senatin e UKZ; në Këshillin Drejtues është një anëtar – student-vëzhgues; në Komisionin për studime dy studentë me të drejtë vote; në Këshillin e Fakultetit studentët janë të përfaqësuar me nga një anëtar për secilën njësi akademike, me të drejtë vote. Për organizimin e aktiviteteve të studentëve, menaxhmenti i UKZ-së ka siguruar përkrahje të plotë, duke siguruar hapësirë të nevojshme dhe logjistikë tjetër të nevojshme.

Organizimi i procesit mësimor në UKZ është gjithnjë në funksion të politikave të Qeverisë për arsimin e lartë në Kosovë. Të gjitha vendimet e sjella nga MASHT implementohen në UKZ.

Në UKZ zbatohet organizimi i kurrikulave (planprogrameve studimore) bazuar në sistemin e tri cikleve të arsimit të lartë, Sistemin Evropian të Transferit të Kredive (ECTS) dhe zbaton të gjitha rekomandimet e procesit të Bolonjës.

Përcaktues i rendësishëm i punës në Universitetin “Kadri Zeka” është Startegjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimit të UKZ-së 2017-2022, i miratuar në Këshillin Drejtues të UKZ në maj 2017.



#### 4. VLERËSIMI I PROGRAMIT

##### 2.3. Misioni, objektivat dhe administrimi

*(Ju lutemi jepni vetëvlerësimin e performancës tuaj ndaj secilit prej standardeve dhe treguesve të performancës të përfshira në këtë fushë të përgjithshme, siç përcaktohet në manualin e Akreditimit të AKA-se)*

Emri i institucionit	<b>Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan Fakulteti Juridik</b>
Emri i programit	<b>Programi: Juridik i Përgjithshëm</b>
KKK Niveli (BA,MA, PhD, etj.)	<b>BA</b>
Grada akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtuar	<b>BSc</b>
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC)	<b>10.0</b>
Profili i programit (specializimi) akademik	<b>Juridik i Përgjithshëm</b>
Kohëzgjatja minimale e studimit	<b>8 semestra, 4 vite</b>
Forma e studimit (e rregulltë, pa shkëputje nga puna, studimi në distancë)	<b>E rregullt</b>
Numri i ECTS kredive (total dhe për vit)	<b>4 X 60, gjithsej 240 ECTS</b>
Lëndët (obligative dhe zgjedhore)	<b>Viti I – Semestri I</b>  O - Fillet e së drejtës O - Teoria dhe praktika parlamentare O – Ekonomia O - Gjuhë e huaj angleze ose Gjuhë e huaj gjermane O - Historia e institucioneve shtetërore dhe juridike Z - Konsumi dhe e drejta e konsumatorëve Z - Sociologjia juridike Z - Hyrje në marrëdhëniet ndërkombëtare Z - Hyrje në të drejtën civile  <b>Viti I – Semestri II</b> O - E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut O - Sistemi gjyqësor dhe profesionet e



	<p>lira në Republikën e Kosovës O - Gjuhë e huaj angleze ose gjuhë e huaj gjermane O - Historia e shtetit dhe e së drejtës shqiptare O - Integrimet ekonomike evropiane Z - E Drejta Romake Z - Komunikimi Masiv, e drejta dhe Politikat Z - Hyrje në të drejtën penale Z – Histori e diplomacisë</p> <p><b>Viti II – Semestri III</b></p> <p>O - E drejta kushtetuese O - E drejta penale O - E drejta civile O - Organizatat ndërkombëtare O - Politika ekonomike Z - Qeverisja lokale Z - E drejta ndërkombëtare e pakicave Z - E drejta e autorit Z - Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në fushën penale</p> <p><b>Viti II – Semestri IV</b></p> <p>O - E drejta administrative O - E drejta familjare dhe trashëgimore O – Kriminalistika O – E drejta financiare O - E drejta e krahasuar Z – E drejta e kadastrit Z - Gjyqësia kushtetuese Z - Shkathtësitë praktike gjyqësore Z - Krimi i organizuar</p> <p><b>Viti III – Semestri V</b></p> <p>O - E drejta ndërkombëtare publike</p>
--	--





	<p>O - Metodologjia e hulumtimit shkencor O - E drejta e unionit evropian O - Procedura administrative O - E drejta tregtare Z - Politika kriminale Z - E drejta e traktateve ndërkombëtare Z - E drejta e sigurimeve Z - Sistemi politik i Kosovës</p> <p><b>Viti III – Semestri VI</b></p> <p>O - E drejta e punës dhe sigurimet sociale O - E drejta e procedurës penale O - E drejta ndërkombëtare private O - E drejta detyrimore O - Klinika juridike penale Z - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare Z - Krimet dhe siguria kibernetike Z - Etika ligjore dhe profesionale Z - Psikologjia gjyqësore</p> <p><b>Viti IV – Semestri VII</b></p> <p>O - E drejta e procedurës civile O - Klinika juridike administrative O - Kriminologji me penologji O - Klinika juridike civile O-Praktika gjyqësore e gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut Z – Politika e Jashtme e BE-se Z - Mjekësia ligjore Z - Përgjegjësia penale e personave juridikë Z- E drejta e arbitrazhit</p> <p><b>Viti IV - Moduli: E drejta kushtetuese dhe administrative</b></p> <p>O - E drejta kushtetuese pozitive O - E drejta administrative-pjesa e</p>
--	--



	<p>posaçme</p> <ul style="list-style-type: none"><li><input type="radio"/> - Sistemet elektorale</li><li><input type="radio"/> - Administrata publike</li><li><input type="radio"/> - Praktika profesionale</li></ul> <p><b>Viti IV – Moduli: E drejta penale</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li><input type="radio"/> - E drejta penale - pjesa e posaçme</li><li><input type="radio"/> - E drejta e procedurës penale – pjesa e posaçme</li><li><input type="radio"/> – Viktimologjia</li><li><input type="radio"/> - E drejta penale ndërkombëtare</li><li><input type="radio"/> - Praktika profesionale</li></ul> <p><b>Viti IV – Moduli: E drejta ndërkombëtare</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li><input type="radio"/> - Siguria kolektive ndërkombëtare dhe NATO</li><li><input type="radio"/> - Teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare</li><li><input type="radio"/> - E drejta ndërkombëtare humanitare</li><li><input type="radio"/> - E drejta diplomatike dhe konsullore</li><li><input type="radio"/> - Praktika profesionale</li></ul> <p><b>Viti IV: Moduli: E drejta civile</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li><input type="radio"/> - E drejta sendore</li><li><input type="radio"/> - E drejta e procedurës civile - pjesa e posaçme</li><li><input type="radio"/> - E drejta kontraktore</li><li><input type="radio"/> - E drejta noteriale</li><li><input type="radio"/> - Praktika Profesionale</li></ul> <p><b>Viti IV – Moduli: E drejta financiare</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li><input type="radio"/> - Institucionet financiare ndërkombëtare</li><li><input type="radio"/> - E drejta ndërkombëtare ekonomike</li><li><input type="radio"/> - Menaxhimi i Burimeve Njerëzore</li><li><input type="radio"/> - E drejta e Biznesit Ndërkombëtar</li><li><input type="radio"/> - Praktika Profesionale</li></ul>
--	--



<b>Numri i vendeve të studimit</b>	250
<b>Udhëheqësi i programit të studimit</b>	Prof. asoc. dr. Sadik Haxhiu
<b>Personeli i përhershëm akademik</b>	Prof. asoc.Dr. Fejzulla Berisha Prof. ass. dr. Fejzullah Hasani Prof.ass.dr. Dukagjin Leka Prof.ass.dr. Urtak Hamiti Prof. ass. dr. Albulena Hajdari Prof.ass.dr. Fadil Osmani Prof.ass.dr. Liridon Dalipi Dr. sc. Fatmire Krasniqi Dr. sc. Selim Daku Ass.PhD.c. Detrina Alishani-SOPI
<b>Taksa e studimit</b>	<b>25 Euro për semestër</b>

Themelimi i *Fakultetit Juridik* mbështetet në këto dokumente:

- Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.03/118, datë: 06/03/2013.
- Statuti i Përkohshëm i Universitetit Publik të Gjilanit datë 12/08/2013
- Strategjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimit të UKZ 2017-2022

Gjatë hartimit të raportit të vetëvlerësimit, të programit Juridik i Përgjithshëm kemi marrë në konsideratë programe të universiteteve, përkatësisht fakulteteve Juridike i: Sarajevës, Lubljanës dhe Sheffield-it.

Legjislacioni në Kosovë kërkon edhe standarde të reja të hartimit të tij, sepse ne jemi një vend aspirant për tu anëtarësuar në familjen e madhe Evropiane – në Bashkimin Evropian, qoftë të legjislacionit primar apo sekondar. Këtë legjislacion duhet ta hartojnë juristët e ardhshëm sipas standardit të Acquis communautaire ku Kosova brenda një dekade do të jetë anëtare me të drejta të plota në Bashkimin Evropian.

Raporti i vetëvlerësimit paraqet risi përmbajtjesore dhe praktike në këtë program, sepse jemi orientuar që të vendosim lëndë aplikative dhe praktike siç janë klinikat juridike dhe praktikën profesionale si lëndë obligative. Këtë e kemi bërë për arsye zhvillimeve të reja shoqërore në Kosovë si dhe të kërkesës së tregut të punës i cili nga viti në vit, po kërkon jurist të diplomuar të cilët duhet të jenë në trend të kohës me njohuri praktike në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës si dhe për institucionet e reja në sistemin e drejtësisë në Kosovë.



### **Ri akreditimi i Fakultetit Juridik duhet të bëhet së paku për këto arsye:**

- *Nevoja e madhe e përgatitjes së juristëve cilësorë në regjionin e lindjes së Kosovës si dhe për Preshevë dhe Bujanovc.*
- *Arritja e rezultateve të deritanishme të studentëve tanë në kryerjen e provimit të jurisprudencës, regjistrimin në master në UP, në gara të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare, në bursa ndërkombëtare, në projekte ndërkombëtare, etj.*
- *Vendosja e lëndëve aplikative dhe praktike në programin e ri për shkak të ndryshimeve të reja në sistemin e drejtësisë në Kosovë, veçanërisht pas fillimit të reformave të reja në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.*
- *Sanksionimi në Kosovë viteve të fundit me ligje i profesioneve të lira siç janë: noteria, ndërmjetësimi, ndihma juridike falas, përmbarimi privat etj.*
- *Promovimi i rezultateve të hulumtimit si për profesorët e fakultetit Juridik të UKZ-së e po ashtu edhe të studentëve;*
- *Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe paraqitja e Fakulteti Juridik të UKZ-së si partner serioz nëpër organizime të konferencave ndërkombëtare, ëorkshope, si dhe organizime të tjera ndërkombëtare;*
- *Projektet ndërkombëtare, ku Fakulteti Juridik ka arritur që të jetë partner serioz me projekte me Ohio Northern University, USAID, OSBE, Ambasadën e SHBA-së në Kosovë, programin Fulbright, Programin Erasmus+, HERAS, etj..*
- *Anëtarësimi nëpër rrjete ndërkombëtare që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë e posaçërisht Fakultetin Juridik, si anëtarësimi në Asociacion Evropian të Fakulteteve Juridike, ku ne jemi anëtarë që nga dhjetori i vitit 2019.*
- *Anëtarësimi në Rrjetin Evropian për Integritet Akademik.*
- *Reformimi i Administratës shtetërore si kriter i BE*
- *Hulumtimi i tregut të punës për Jurist të diplomuar, avokatë, prokurorë, gjykatës, noterë, përmbarues, zyrtar ligjor, sekretarë, etj., në rajonin e Gjilanit, të Ferizajt dhe për Luginën e Preshevës.*
- *Prandaj me të drejtë vlerësojmë nga ana e jonë se nga ajo që u theksua më lartë, ri akreditimi i Fakultetit Juridik është në përputhje me parimet dhe me misionin e universitetit për të kontribuar në zhvillimin dhe përparimin e sistemit juridik dhe gjyqësor, si dhe me nevojat e tregut të punës. Programi i tillë i studimeve themelore në Fakultetin Juridik të UKZ-së, i propozuar për ri akreditim është përgatitur që të jetë në harmoni me kërkesat e sistemit të qeverisjes dhe sistemin gjyqësor në Kosovë.*

Lëndët e kombinuara teorike dhe praktike do të ofrojnë për studentët edhe mundësi të studimeve përmes rasteve studimore të cilat do t'i përzgjedhin studentët në bashkëpunim me profesorët e lëndëve dhe profesorët do të ofrojnë bashkëpunim me ekspertët e fushave të specializuara të cilët, njohuritë e tyre mund t'i demonstrojnë te studentët gjatë ligjëratave. Kjo



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



---

do të bëhet në bashkëpunim me avokatë, gjyqtarë, prokurorë, noterë, përmbarues, hartues të ligjeve etj.

Së këndejmi, definohet edhe vizioni dhe misioni i Fakultetit Juridik në kuadër të vizionit dhe misionit të UKZ-së:



**Misioni i Fakultetit Juridik** është: *të promovojë dhe të angazhoj studentët për një hulumtim të vazhdueshëm të zhvillimit dhe edukimit në aspektin e së drejtës (long life learning process), si një prej instrumenteve më vitale të shtetit për përmirësimin e jetës shoqërore në vend, duke i kushtuar kujdes të veçantë faktit që studentëve t’u mësohet se e drejta është mjeti kryesor me të cilin luftohen të gjitha padrejtësitë shoqërore.*

Programi i Fakulteti Juridik në Universitetin “Kadri Zeka” synon që juristët e diplomuar në programin juridik i përgjithshëm të jenë të aftë të ushtrjnë profesionin e juristit të diplomuar dhe në ofrimin e shërbimeve juridike në Republikën e Kosovës dhe më gjerë. Si rezultat, pas përfundimit të këtij programi, studentët do të fitojnë njohuri dhe shkathtësi të zbatueshme teorike dhe praktike. Studentët do të kenë mundësi që të marrin njohuritë bazë për sistemin e jurisprudencës dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë në përgjithësi, ushtrimin e profesionit të zyrtarit ligjor, të avokatit praktikant dhe të shërbyesit civil në administratën publike, në kompanitë private, në departamentet e shërbimit juridik, noteri, ndërmjetësim, përmbarim, ndihmë juridike falas, OJQ etj., duke mbuluar konceptet kryesore, praktikat dhe teknikat e hartimit të shkresave ligjore dhe komunikimin ligjor. Ky program gjithashtu zhvillon aftësi analitike, krahasimtare, praktike që ndërlidhën me ushtrimin e profesionit të juristit të diplomuar.

Programi juridik i përgjithshëm është i kombinuar me lëndë teorike dhe praktike, ku secila nga lëndët ka ndërlidhje me tjetrën, ndërsa lëndët nga viti i tretë dhe i katërt dhe lëndët e semestrit të tetë – modulare, kanë një ndërlidhje të drejtpërdrejtë me lëndët praktike. Raporti i pjesës teorike me atë praktike konkretisht vërehet te disa lëndë, si p.sh.: E drejta civile që është lëndë teorike dhe ka një raport me lëndët praktike siç janë: Klinika juridike civile; E drejta penale, e cila ka një raport me lëndën praktike Klinika juridike penale; E drejta administrative si lëndë teorike, e cila ka një raport me lëndën praktike Klinika administrative dhe E drejta kushtetuese që ka një raport praktik me lëndën gjyqësia kushtetuese si dhe Lenda E Drejta Nderkombetare për të Drejtat e Njeriut si dhe E Drejta e Minoriteteve ka lidhje direkte me lëndën praktike Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Po ashtu vlen të theksohet fakti se një risi që e kemi sjellë në kuadër të këtij programi janë edhe Klinikat ligjore si lëndë obligative, si dhe praktikat e gjykatave, sic është rasti me Praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Si dhe shumë e rëndësishme është futja e Praktikës Profesionale si lëndë obligative në semestrin e fundit për secilin modul, ku studenti në përfundim të fakulteti është i detyruar të kryejë një semester punë praktike në ndonjë institucion publik apo privat në Kosovë dhe të bëjë një raport vetë vlerësues për punën praktike, e cila pastaj vlerësohet nga profesori i lëndës.

Mësime praktike po ashtu do të organizohen edhe në objektin e universitetit, në sallën A-34, e cila është e përshtatshme për simulim të seancave gjyqësore dhe mbajtje të mësimit klinik.



Nga ajo që u shtjellua më lartë, ne paraqitëm aspektin se përgatitja e programit të studimeve *juridik i përgjithshëm* përfshinë në vete edhe punën teorike - praktike që zhvillohet përmes lëndëve teorike – praktike. Fakulteti Juridik, duke pasur parasysh se kjo nuk është e mjaftueshme, ka shtyrë Universitetin “Kadri Zeka” që të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, ku studentët mund të kryejnë praktikën në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe degët e saj në Kamenicë, Viti dhe Artanë.

UKZ po ashtu ka lidhë marrëveshje edhe me Komunën e Gjilanit, Kamenicës, Ferizajt, Vitisë, Kaçanikut dhe Hanit të Elezit, ku studentët mund të kryejnë praktikën në administratë, në të gjitha organet e qeverisjes lokale. Po ashtu Fakulteti ka lidhë marrëveshje bashkëpunimi me Odën e Avokatëve të Kosovës, ku studentët tanë mund të përfundojnë praktikën nëpër avokatë në të gjitha komunat në Lindje të Kosovës dhe më gjerë, etj.

Në Fakultetin Juridik, studimet Bachelor organizohen në 8 semestra (4 vjet), me një program i cili ofron një total prej 240 ECTS-ve dhe rreth 6000 orë mësimore për lëndët të cilat ofrohen për studim. Pas diplomimit, studentit i jepet titulli Jurist i Diplomuar (B.Sc).

Në vitin e parë të studimeve sivjet janë regjistruar 250 studentë. Deri më tani (prej vitit 2017 kur ka diplomuar gjenerata e parë e deri me tani) kanë diplomuar, 194 studentë.

Fakulteti Juridik zbaton sistemin e kredive (ECTS) për programin e studimit në të gjitha lëndët. Për secilën lëndë hartohet syllabusi, i cili përshkruan në hollësi të dhënat për emërtimin, programin, kreditë ECTS, mësimdhënësin, qëllimet, etj. Në këtë nivel zakonisht kërkohet aplikimi i teorisë, principeve dhe metodave të bazuara në njohuritë teorike dhe praktike dhe të kuptuarit e një fushe të punës ose studimit, si dhe përdorimin konsistent të gjykimit në hulumtime, analiza, interpretime dhe aplikime të teorive, principeve dhe metodave.

Po ashtu, kërkohen shkathtësi për marrje të përgjegjësive dhe përmirësim të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave më të gjëra drejt specializimit të mëtejshëm.

Një nga pikat e rëndësishme është llogaritja e ECTS për secilën lëndë në veçanti dhe për semestrin gjegjësisht për programin e studimit.

Formula e llogaritjes së ECTS është bazuar në shumën e orëve të: *ligjëratave (leksioneve), punës praktike, seminareve, punës individuale (në bibliotekë apo në shtëpi) dhe provimeve apo aktiviteteve tjera vlerësuese*. Në këtë mënyrë, duke llogaritur se gjatë javës studenti angazhohet 40 orë dhe viti shkollor i ka 37 javë ligjëratave, ushtrime laboratorike, studim të pavarur, provime, testime, etj (shih më poshtë), fitojmë angazhimin total të studentit gjatë vitit akademik:

$$\text{Angazhimi i studentit gjatë një viti} = 40 \frac{\text{ore}}{\text{jave}} \circ 37 \frac{\text{jave}}{\text{vit}} = 1480 \frac{\text{ore}}{\text{vit}}$$



Prandaj studenti gjatë vitit akademik do të akumulojë 60 kredi për të përfunduar vitin me sukses, pra:

$$60 \frac{ECTS}{vit} = 1480 \frac{ore}{vit}, \Rightarrow 1ECTS \approx 25 ore$$

Duke llogaritur që numri i përgjithshëm i orëve në semestër të jetë 750 duke përfshirë këtu edhe *ligjëratat (leksionet), ushtrimet, puna praktike, seminarët, puna individuale (në bibliotekë apo në shtëpi)* dhe *provimet apo aktivitetet e tjera vlerësuese* në të gjitha LËNDËT që e formojnë strukturën e programit mësimor për semestër.

Kreditë për secilën lëndë veç e veç përcaktohen individualisht nga mësimdhënësi, duke u kujdesur gjithnjë që të mos tejkalohen 750 orë apo 30 kredi të përgjithshme për një semestër. Në rastet kur është paraqitur numri jo i plotë i kredive, është lejuar rrumbullakësimi, p.sh., në rastin kur një lëndë ka 135 orë, atëherë ajo ka 5 kredi (por kanë mund të jenë edhe 6 kredi), kurse lënda që ka 105 orë do të ketë 4 kredi. Numri i kredive ECTS për lëndët mësimore, për semestrin, si dhe përmbajtjet e lëndëve janë dhënë në këtë raport në planin e studimit (shih pika 3.4.13). Pikët kredituese fitohen me dhënien e provimeve dhe studenti do të fitojë aq kredi sa kredi janë paraparë me planin e studimeve për atë lëndë.

Studenti për arritjen e shkallës akademike Jurist i Diplomuar - Baçelor është i obliguar që të akumulojë së paku 240 ECTS.





### **Analiza SWOT për misionin, objektivat dhe administratën:**

*(ju lutemi shënoni perspektivën tuaj mbi pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe sfidat në lidhje me operacionet institucionale. Këto mund t'i referohen faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë performancën institucionale kundrejt standardeve dhe treguesve të performancës të përfshira në këtë fushë të përgjithshme, siç përcaktohet në manualin e Akreditimit të AKA-së).*

#### **A. Pikat e forta:**

- Fakulteti Juridik në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan do të ofrojë një qasje evropiane dhe bashkëkohore të studimit, e cila do të ju sigurojë studentëve të tij trajnimin e nivelit më të lartë juridik në Kosovë, me qëllimin që t'i aftësojë ata të fillojnë një karrierë në shërbim të ligjit dhe shoqërisë, e cila do të karakterizohet me një angazhim maksimal profesional ndaj drejtësisë dhe standardeve të larta etike që ndërlidhen dhe nevojiten për funksionimin e drejtësisë.
- Stafi akademik i Fakultetit Juridik të UKZ-së, i cili ka ardhur me përgatitje adekuate dhe me përvoja ndërkombëtare të mësimdhënies. I gjithë stafi akademik në Fakultetin Juridik ka shënuar *rezultate* dhe ka publikuar *punime të rëndësishme* në institucionet e rëndësishme të arsimit juridik në Evropë dhe botë. Me punimet dhe paraqitjet e kumtesave të tyre, ata kanë marrë pjesë në konferenca lokale, regjionale dhe ndërkombëtare. Ata kanë publikuar punime shkencore me impakt ndërkombëtar, e të cilat janë të indeksuara në databazat kryesore ndërkombëtare, si Eeb of Science, Scopus, DOAJ, EBSCO, etj., e të cilat janë edhe si kritere vlerësuese për avancimin e personelit tonë akademik. Të gjitha këto përvoja ndërkombëtare do të sillen dhe do të implementohen në Fakultetin Juridik të UKZ-së.
- Kualiteti i studimeve në Fakultetin Juridik bënë që ende të kemi një numër më të madh të aplikantëve se sa që ne mund të pranojmë. Ne çdo vit akademik, ne pranojmë 1 nga 3 aplikantë për Fakultetin Juridik, që nënkupton se ky fakultet është treguar dhe gjithnjë e më shumë po tregohet si i suksesshëm. Madje në vitin akademik 2019/20 kanë mbetur pa u regjistruar edhe kandidatë me sukses të shkollimit të mesëm të shkëlqyeshëm.
- Praktika profesionale që bëhet tek ne është e një niveli jashtëzakonisht të lartë, e cila edhe është vlerësuar shumë mirë nga USAID, Ambasada e SHBA-ve në Kosovë dhe madje edhe nga vetë Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shkëlqesia e tij z. Philip Kosnet.



- Universiteti “Kadri Zeka” prinë në Kosovë me projekte nën programin Ngritja e Kapaciteteve - Erasmus +, ku UKZ tani është në 7 projekte aktive, ku në njërin është si koordinator. Vlen të theksohet fakti se projekti ENEMLOS së bashku me Universitetin e Podgoricës ka të bëjë pikërisht me zhvillimin e Klinikave Juridike.
- Rezultatet e studentëve tanë nëpër konteste të ndryshme në Kosovë, aplikime nëpër programe Master, bursa studimore, projekte të ndryshme, siç është rasti me projektin HERAS për personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës, pastaj përfundimi i provimit të jurisprudencës, etj.
- Anëtarësimi i Fakultetit Juridik nëpër rrjete dhe asociacione ndërkombëtare, siç kemi arritur të bëjmë me anëtarësimin e Fakultetit Juridik në Asociacionin e Fakulteteve Juridike të Evropës. Anëtarësimi në rrjete ndërkombëtare që kanë të bëjnë me hulumtimin, e ku UKZ është anëtarësuar në rrjetin evropian për Integritet Akademik.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe paraqitja e Fakulteti Juridik të UKZ-së si partner serioz nëpër organizime të konferencave ndërkombëtare, ëorkshope, si dhe organizime të tjera ndërkombëtare;
- Projektet ndërkombëtare, ku Fakulteti Juridik ka arritur që të jetë partner serioz me projekte me Ohio Northern University, USAID, OSBE, Ambasadën e SHBA-së në Kosovë, programin Fulbright, Programin Erasmus+, HERAS, etj..

## **B. Dobësitë**

- Mungesë e infrastrukturës në UKZ për të avancuar edhe më tutje zhvillimin e Klinikave Juridike dhe
- Mungesë e vullnetit nga Avokatët, Gjykatësit, Prokurorët, Noterët, etj, që të vijjnë dhe të mbajnë orë praktike vullnetare me studentët tanë, pavarësisht angazhimit tonë maksimal.

## **C. Mundësitë**

- Përgatitja e mësimeve të Fakultetit Juridik me mësimin e shekullit XXI, duke ecur me kohën dhe me avancimet në mësime bashkëkohore.
- Krijimi i komunitetit të juristëve të rinj, si alumnit e po ashtu edhe klubet e juristëve, të cilët së bashku me profesorët organizojnë debate të ndryshme për çështje ligjore, siç është rasti me USAID, OSBE-në, UNICEF, GIZ, Policinë e Kosovës, Gjykatat, Prokuroritë, Avokatët, etj. Këto kanë krijuar edhe ndihmat juridike falas, që së bashku me projektin e USAID kanë arritur që të japin ndihma juridike falas.



- Që shollat e mesme Juridike të fillojnë që të përgatisin edhe më mirë nxënës nga lëmia juridike, sepse ne si fakultet do të kishim edhe më shumë mundësi që të nxirrim edhe më tepër studentë kualitativ.

#### **D. Sfidat**

- Studenti ka një numër të madh lëndësh zgjedhore, që i japin atij mundësinë për tu zgjedhur; pastaj se klinikat juridike janë të avancuara dhe janë duke u zhvilluar edhe më tutje nëpërmjet projekteve ndërkombëtare; se praktika profesionale është futur si lëndë obligative dhe se modulet janë avancuar gjithnjë e më shumë me lëndë bashkëkohore, të cilat janë krahasuar me universitete nga Evropa dhe rajoni të cilat paraqesin sfida për realizimin e tyre.
- Pamundësia që të përcillet zhvillimi i literaturës më bashkëkohore, e cila është më se e nevojshme për të krijuar kuadro që janë të përgatitur për ushtrimin e profesionit në kohën bashkëkohore.



## 2.2. Menaxhimi i cilësisë

*(Ju lutemi jepni vetëvlerësimin e performancës tuaj ndaj secilit prej standardeve dhe treguesve të performancës të përfshira në këtë fushë të përgjithshme, siç përcaktohet në manualin e Akreditimit të AKA-së.)*

Universiteti “Kadri Zeka” (më tej UKZ), në përpjekje të sigurimit të cilësisë në aspektin institucional, përfshirë këtu të gjitha aktivitetet akademike të realizuara brenda institucionit përkatës vazhdon të ketë në fokus realizimin e studimeve sa më cilësore. Sigurimi i burimeve adekuate njerëzore, përcaktimi i kompetencave (caktimi dhe shpërndarja e përgjegjësive), menaxhimi cilësor si dhe përcaktimi adekuat i formës së raportimit në lidhje me përgjegjësitë e marra, gjithnjë e më tepër kontribuojnë në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, të ofruar nga UKZ.

I tërë sistemi i realizimit të cilësisë brenda UKZ-së, bazohet në kornizën e pasur normative e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë i kontribuon përmbushjes së synimeve të institucionit përkatës. Rrjedhimisht, të gjitha aktivitetet si dhe procedurat e aplikuara brenda UKZ-së mbështeten në kornizën normative si në vijim:

1. *Ligji mbi Arsimin e Lartë të Kosovës,*
2. *Statuti i UKZ-së,*
3. *Rregullorja për procedurat e sigurimit të cilësisë në UKZ,*
4. *Standardet e sigurimit të brendshëm të cilësisë për Universitetin “Kadri Zeka”, Gjilan,*
5. *Udhëzuesi për vlerësimin e Stafit Akademik dhe lëndëve*
6. *Rregullorja për masat disiplinore shtesë si dhe*
7. *Rregullorja për Kodin e Etikës në UKZ.*

Theksojmë se, procedurat e sigurimit të cilësisë në UKZ, respektojnë dhe mbështeten edhe në *Standardet e Sigurimit të Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area ESG)*. (Të bashkangjitura gjeni aktet normative përmes të cilave sigurohet cilësia akademike në UKZ).<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Aktet normative dhe linqet e tyre:

1. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761;>
2. <https://www.uni-gjilan.net/dokumentet/statuti-i-universitetit-kadri-zeka-gjilan>
3. [https://www.uni-gjilan.net/ep-content/uploads/2016/05/Rregullore-ABr-procedurat-e-sigurimitAB.pdf;](https://www.uni-gjilan.net/ep-content/uploads/2016/05/Rregullore-ABr-procedurat-e-sigurimitAB.pdf)
4. [https://www.uni-gjilan.net/ep-content/uploads/2016/09/Rregullore-p%C3%ABr-zgjedhjen-e-personelit-akademik-n%C3%ABr-Universitetin-Kadri-Zeka-n%C3%ABr-Gjilan.pdf;](https://www.uni-gjilan.net/ep-content/uploads/2016/09/Rregullore-p%C3%ABr-zgjedhjen-e-personelit-akademik-n%C3%ABr-Universitetin-Kadri-Zeka-n%C3%ABr-Gjilan.pdf)



Gjithnjë në funksion të krijimit dhe menaxhimit të cilësisë, UKZ ka themeluar edhe *Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Cilësi* e cila është urë lidhëse ndërmjet mekanizmave të domosdoshëm në realizimin e cilësisë, me theks të veçantë ajo koordinon aktivitetet ndërmjet zyrës përkatëse dhe Senatit të UKZ-së, Këshillit Drejtues, njësive akademike, këshillave të fakulteteve, komisioneve dhe grupeve të tjera punuese.

Gjithashtu, në bashkëpunim me *Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, Fakulteti Juridik* ka caktuar edhe Koordinatorin për Cilësi, i cili ka detyra dhe përgjegjësi të rëndësishme në rrafshin e të siguarit të cilësisë brenda njësisë akademike përkatëse. Për më tepër, Koordinatorin e Cilësisë, është një nga anëtarët e stafit akademik. Si i tillë, Koordinatorin është urë lidhëse në mes njësisë akademike dhe *Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi të Universitetit*. Koordinatorin, në përpjekje të sigurimit të cilësisë i raporton menaxhmentit të fakultetit dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi: udhëzon stafin akademik dhe studentët në kuadër të njësisë akademike lidhur me aspektet praktike dhe akademike të zbatimit të ECTS-së; në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike, përkujdeset dhe monitoron përfshirjen e të gjitha palëve me interes (stafi akademik, studentëve, bizneseve, anëtarëve të Bordit këshilldhënës, etj.), për hartimin/rishikimin e programeve të studimit gjatë procesit të ri/akreditimit; Koordinatorin për cilësi është pjesë e planifikimit dhe monitorimit të procesit të vlerësimit të lëndëve dhe mësimdhënësve, si dhe vlerësimit të brendshëm të cilësisë; në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike ndihmon në sistemimin e të dhënave dhe informatave lidhur me aktivitetin shkencor/artistik në njësinë akademike (evidentimin e punimeve shkencore, performancës artistike, projekteve profesionale dhe shkencore); Koordinatorin këshillon, planifikon, dhe monitoron skema, aktivitete dhe veprimtari për ngritjen e cilësisë në njësinë akademike. Po ashtu, Koordinatorin kujdeset për cilësinë e dokumenteve dhe informacioneve nga fusha akademike e fakultetit të publikuara në web-faqe.

Në anën tjetër, për të realizuar një nivel sa më adekuat të cilësisë, në mënyrë periodike bëhet vlerësimi i stafit akademik si dhe i lëndëve, i cili është vlerësim i rregullt brenda UKZ-së, e në këtë kuptim edhe brenda njësisë sonë akademike, përkatësisht brenda *Fakultetit Juridik*.

Një vlerësim i tillë do të realizohet në dy sesione. Sesiioni i parë do të përfshijë vlerësimin pas përfundimit të *semestrit dimëror* si dhe sesiioni i dytë do të përfshijë vlerësimin pas përfundimit të *semestrit veror*. Me qëllim të transparencës, *Zyra për Zhvillim Akademik*

5. <https://www.uni-gjilan.net/ep-content/uploads/2016/05/Standardet-e-sigurimit-t%C3%AB-brendshem-UniversitetinKadri-Zeka-Gjilan.pdf>;
6. <https://www.uni-gjilan.net/ep-content/uploads/2017/07/Masat-disciplinore-shtese.pdf>;  
<https://www.uni-gjilan.net/ep-content/uploads/2018/03/Rregullore-p%C3%ABr-Kodin-e-Etik%C3%ABs-n%C3%AB-UKZ.pdf>



*dhe Cilësi*, do të publikojë edhe në web faqen zyrtare të UKZ-së, raportin përmbledhës dhe të detajuar të një procesi të tillë, gjithnjë në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies sa më adekuate.

Duke kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në realizimin e cilësisë brenda *Fakultetit Juridik* të UKZ-së, veçanërisht në realizimin e një performace akademike sa më adekuate, njësia akademike përkatëse motivon dhe mbështetë aplikimin edhe të instrumenteve të ndryshme dhe me theks të veçantë të: raportimeve, ankesave, anketave, pyetësorëve dhe aktiviteteve të tjera të vazhdueshme të studentëve përmes të cilave ata bëhen pjesë e sigurimit dhe përmbushjes së cilësisë brenda *Fakultetit Juridik*, të UKZ-së. Në këtë drejtim, *Fakulteti Juridik* përmes: *Dekanit, Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi si dhe Koordinatorit për Cilësi*, do të hartojë pyetësorin i cili në mënyrë periodike do të evoluojë dhe i cili do t'i kontribuojë edhe paraqitjes së vlerësimit të studentëve në mënyrë anonime, rreth jetës akademike në tërësi në këtë njësi akademike.

Kontrollimi dhe menaxhimi i cilësisë në *Fakultetin Juridik-Programin Juridik i Përgjithshëm* realizohet në mënyrë periodike gjë që për çdo vit akademik ky proces i rëndësishëm kalon

nëpër disa stade të domosdoshme. Rrjedhimisht:

- **Stadi i parë:** në javën e parë të çdo semestri vijues, mësimdhënësi do të prezantojë dhe do të ofrojë planin e tij të punës në lidhje me lëndën të cilën ai do ta ligjërojë. Syllabusi i lëndës përkatëse (të gjitha syllabuset e të gjitha lëndëve do të jenë të prezantuara në formën elektronike në ëeb faqen e UKZ-së), do t'u shpërndahet studentëve (në formë elektronike ose në kopje fizike), gjë që atyre do t'ju mundësojë orientimin adekuat në aspektin e mësimdhënies dhe mësimnxënies shumë më cilësore.
- **Stadi i dytë:** pas çdo ore të mbajtur, mësimdhënësi do të dorëzojë raportet me të dhënat e *tematikës* së shtjelluar para studentëve, me çka do t'i kontribuohet realizimit gradual të planit studimor të prezantuar nga mësimdhënësi përkatës që në fillim të semestrit akademik, përkatësisht obligimeve të marra nga mësimdhënësi në raport me njësinë akademike si dhe me studentët.
- **Stadi i tretë:** në fund të çdo muaji kalendarik, mësimdhënësi do të dorëzojë në njësinë akademike raportin mujor për aktivitetin e tij akademik, gjë që akoma më shumë forcon përgjegjësinë e tij në raport me njësinë akademike dhe studentët, gjithnjë në funksion të përmbushjes së planit studimor të prezantuar më parë para tyre.
- **Stadi i katërt:** në fund të çdo semestri, mësimdhënësi do të paraqes raport në njësinë akademike duke shpalosur të arriturat apo edhe mangësitë eventuale në realizimin planit studimor për lëndën e caktuar.
- **Stadi i pestë:** studentët përmes shprehjes së tyre të lirë dhe anonime, do të përgjigjen



në pyetësorët e prezantuar nga *Koordinatori i Cilësisë së Fakultetit Juridik*, duke dhënë kështu një kontribut të çmueshëm në vlerësimin edhe të stafit akademik por edhe të lëndëve.

- **Stadi i gjashtë:** nga raportet e mbledhura, *Koordinatori për Cilësi i Fakultetit Juridik*, do të përpunojë të dhënat, do të bëjë krahasimin e tyre, përputhshmërinë e të dhënave të prezantuara nga mësimdhënësi me planin studimor semestral, angazhimin dhe përkushtimin e tij gjatë procesit të mësimdhënies, raporteve të vlerësimit të studentëve etj., dhe i njëjti do të arrijë që të krijojë një raport unik për secilin mësimdhënës veç e veç.
- **Stadi i shtatë:** nga raportet e mbledhura, dekani i fakultetit do të shkruajë *Raportin vlerësues*, i cili do të bëhet pjesë e dosjes personale për çdo mësimdhënës apo asistent.

Rrjedhimisht, në fund të çdo semestri, por edhe në fund të çdo viti akademik, në kuadër të *Fakultetit Juridik*, do të publikohet në ëeb faqe të UKZ-së, *Raporti përmbledhës për vlerësimin e stafit akademik dhe të lëndëve*, ku në mënyrë të detajuar do të pasqyrohen të arriturat dhe mangësitë për semestrin ose vitin akademik të përfunduar. Paraqitja në formën e tillë gjithësesi se i kontribuon ngritjes së cilësisë së jetës akademike brenda *Fakultetit Juridik* të UKZ-së, motivon edhe më shumë stafin akademik si dhe në anën tjetër i kontribuon evidentimit të mangësive eventuale, gjithnjë me synim të eliminimit të tyre.

### **Analiza SWOT për menaxhimin e cilësisë:**

(ju lutemi shënoni perspektivën tuaj mbi pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe sfidat në lidhje me operacionet institucionale. Këto mund t'i referohen faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë performancën institucionale kundrejt standardeve dhe treguesve të performancës të përfshira në këtë fushë të përgjithshme, siç përcaktohet në manualin e Akreditimit të AKA-së)

#### **A. Pikat e forta**

- *Fakulteti Juridik-Programi Juridik i Përgjithshëm*, në aspektin e përmbajtjes së programit studimor do të ketë përputhje të lartë me standardet akademike vendore dhe ndërkombëtare. Si modele të krahasueshme i kemi marrë edhe modelet e vendeve regjionale dhe evropiane si: *Universiteti i Ljubljanes*, *Universiteti i Sarajevës* dhe *Shefield-it*.
- Programi përkatës edhe në aspektin e mësimdhënies dhe mësim nxënies do të ofrojë cilësi po ashtu të lartë. Studentët të cilët do të jenë pjesë e një programi të tillë, konsiderojmë se do të jenë të suksesshëm edhe në tregun e punës. Për më tepër, marrja e njohurive nga një program i tillë, ndikon fuqishëm edhe në



plotësimin e profilit të tyre profesional. Për rrjedhojë, veçantitë e programit të studimeve të cilat do të realizohen do t'i kontribuojnë akoma më shumë suksesit të studentëve tanë.

- Mësimdhënia dhe mësimnxënia do të jetë e gërshetuar ndërmjet anës teorike dhe asaj praktike, gjë që studentët i bënë shumë më efikas në marrjen dhe aplikimin e dijes së tyre pas përfundimit të studimeve në *Fakultetin Juridik*. Një nga arritjet e rëndësishme në kuadër të këtij programi është veçanërisht përfshirja e lëndëve të reja në planin studimor-shkencor, përfshirja e lëndëve të cilat lidhen drejtpërdrejtë me praktikën, me theks të veçantë të *Mësimin klinik në kuadër të pesë moduleve dhe praktikës profesionale në vitin e IV, semestri i tetë*. Megjithatë, përtej përgatitjes për tregun e punës të juristëve të ardhshëm, niveli i studimeve të parapara në këtë program do të ofrojë mundësi që në të ardhmen të prodhojmë kuadro profesionale edhe në kuptim të profesionistëve -kërkuesve shkencorë. Në këtë drejtim, ndikim të fuqishëm do të kenë edhe praktika profesionale si kusht për diplomimin e tyre.
- Ligjëratat dhe ushtrimet në klasë, do të mbahen duke konsultuar literaturën më të re në kuptim të teksteve studimore-shkencore.
- Mbështetur në bashkëpunimin institucional që UKZ ka me institucione të tjera akademike brenda dhe jashtë vendit, mësimdhënësit tanë do të kenë mundësi angazhimi edhe në institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Për më tepër, falë bashkëpunimit të arritur të UKZ-së, edhe studentët tanë dhe të huaj do të jenë në lëvizshmëri periodike gjë që atyre do t'u ofrohet jo vetëm afirmim i ndërsjellë por edhe zhvillim cilësor dhe akademik shumë më adekuat.
- Marrëveshjet e realizuara nga UKZ si dhe ato të cilat çdo ditë e më tepër ky institucion i arsimit të lartë po i realizon, jo vetëm me institucionet e drejtësisë, siç janë: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial, Avokatin e Popullit, gjykatat, prokuroritë, administrata lokale dhe qendrore, si dhe institucionet e pavarura të drejtësisë. Ky fakultet, gjithnjë e më tepër do të shndërrohet në faktorë të fuqishëm kontribuues në kuptim të ngritjes së cilësisë së arsimit jo vetëm brenda UKZ-së, por edhe në tërë territorin e vendit.
- Personeli akademik është në një shkallë të avansuar të kualifikimit profesional dhe akademik, ndërkohë interesimi i vazhdueshëm i tij do të jetë i fokusuar në planin kërkimor-shkencor gjë që do të jetë kontribuues i drejtpërdrejtë edhe në cilësinë akademike brenda *Fakultetit Juridik*.





- Programi studimor do të përditësohet vazhdimisht, konformë ndryshimeve në sistemin e drejtësisë brenda shtetit, si dhe konformë trendëve të zhvillimit të shkencave juridike në përgjithësi.
- Studentët e shkëlqyeshëm vazhdimisht do të motivohen për angazhimin e tyre në aspektin e mësimnxënies, duke u ofruar mirënjohje por edhe mundësi të bashkëpunimit në rrethanat kur ata do të mund të kontribuonin edhe në ngritjen e cilësisë brenda *Fakultetit Juridik* gjë që, kërkesat dhe qëndrimet e tyre do të merren parasysh.
- Studentë më të dalluar kryesisht kanë përparësi në marrjen e bursave që ndanë universiteti, institucionet donatore si dhe mundësia e tyre për vizita studimore nëpër institucione simotra në rajon dhe në universitetet e ndryshme nëpër Evropë, aty ku UKZ-ja ka marrëdhënie bashkëpunimi.

## B. Dobësitë

- Mungesa e një gjykatoreje të improvizuar për studentët e *Fakultetit Juridik*, të cilët do të realizonin njohuritë e tyre teorike në aspektin praktik..
- Mungesa e disa prej mjeteve teknike përmes të cilave do të bëheshin eksperimente në kuptim të sqarimit të mënyrës së identifikimit të gjurmëve, e cila do të ishte me interes themelimi i kabinetit të kriminalistikës, dhe ai i mjekësisë ligjore.
- Njohuritë jo të kënaqshme të gjuhës angleze nga ana e studentëve, përmes të cilës komunikohet me lehtë me literaturën shkencore.
- Mungesa e disa prej titujve shkencorë plotësues në Bibliotekën e UKZ-së.

## C. Mundësitë

- *Fakulteti Juridik, Programi Juridik i Përgjithshëm* në aspektin e përmbajtjes së programit si dhe në aspektin e të realizuarit në praktikë të programit përkatës është mjaft i ndryshëm në raport me programet simotra në nivel vendi. Për rrjedhojë, studentëve do t'u ofrohet qasje më e lehtë në fitimin e njohurive të nevojshme në aspektin teorik (fokusimi më i madh te lëndët juridike pozitive) dhe në mënyrë të posaçme në aspektin praktik, përmes klinikave juridike dhe praktikës obligative profesionale.
- Bashkëpunimi dhe bashkë koordinimi i vazhdueshëm në realizimin e programit studimor ndërmjet mësimdhënësve dhe studentëve, do të krijojë një



sistem adekuat të mësim nxënies dhe një liri më të theksuar të studentëve në paraqitjen dhe trajtimin e tematikave me interes për ta, gjithnjë në funksion të përgatitjes profesionale sa më adekuate të tyre.

- Brenda *Fakultetit Juridik*, Programi Juridik i Përgjithshëm, vazhdimisht organizohen aktivitete edukative, kërkimore dhe shkencore, përmes: temave debutuese, tribunave, tryezave të rrumbullakëta, seminare etj. të cilat gjithnjë e më tepër i kontribuojë ngritjes edhe të cilësisë.

#### D. Sfidat

- Organizimi i konferencës shkencore në intervale të caktuara kohore, e ndarë në pesë module, konformë programit modular. Fakulteti Juridik ka një staf akademik që vazhdimisht po merr pjesë nëpër konferenca shkencore me karakter vendor, regional dhe ndërkombëtar, prandaj ky staf është i përgatitur për të marrë këtë nismë për organizimin e konferencës shkencore nga fushat juridike të ndarë nëpër sesione modulare.
- Me qëllim të realizimit akoma më të lartë të cilësisë në UKZ, e në këtë kuptim edhe në kuadër të *Fakultetit Juridik*, synim kryesor mbetet planifikimi, organizimi dhe fillimi i publikimit të një reviste kërkimore-shkencore, e cila do të motivonte akoma më shumë stafin akademik si dhe studentët e interesuar të këtij niveli të studimeve në aspektin kërkimor-shkencor.

#### 2.4. Stafi akademik

(Ju lutemi jepni vetëvlerësimin e performancës tuaj ndaj secilit prej standardeve dhe treguesve të performancës të përfshira në këtë fushë të përgjithshme, siç përcaktohet në manualin e Akreditimit të AKA-se)

Stafi akademik i Fakultetit Juridik ka marrë pjesë në konferenca shkencore vendore, regionale dhe ndërkombëtare, duke publikuar punime kërkimore-shkencore nëpër revista



kredibile ndërkombëtare. Po ashtu stafi i Fakultetit Juridik, merr pjesë vazhdimisht në vizita studimore, tryeza shkencore, debate publike, etj.

**Bartësi i Programit Juridik i Përgjithshëm Prof.Asoc.Dr. Sadik Haxhiu**, ka kryer Fakultetin dhe studimet posdiplomike në Fakultetin Juridik Universitetin e Prishtinës. Ndërsa, studimet e doktoratës i ka përfunduar në Departamentin Kushtetues Administrativ në Universitetin e Bihaç-it në Bosnje dhe Hercegovinë në fushën e Sistemeve elektorale. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore vendore, regjionale dhe ndërkombëtare, si dhe ka publikuar 7 punime shkencore me impact faktor. Ka hartuar 3 tekste universitare dhe një monografi nw dorëshkrim – (në gjuhën angleze) dhe pritet së shpejti ta publikoj. Ka marrë pjesë në dhjetëra komisione për hartimin e ligjeve në Kosovë, ku në disa prej tyre ka qenë kryetar komisioni. Ka udhëhequr (mentoruar) 22 kandidatë në studimet master si dhe ka marrë pjesë në 2 komisione për mbrojtjen e doktoratës.

**Prof.asoc.dr. Fejzulla Berisha:**

Prof.Asoc.Dr. Fejzulla Berisha ka mbaruar Fakultetin Juridik ne UP, dhe titullin e magjistrat të shkencave juridike-kushtetuese administrative e ka mbaruar ne Universitetin e Prishtinës,viti 1981 perkatësisht 1993. Doktoraturën e ka mbrojtur më 6 Prill 1999. Ka dhënë kontributin e tij në shumë universitete të rajonit, si në Universitetin e Tiranës,"USHT"Tetovë, "Ukshin Hoti" në Prizren, "Hasan Prishtina"në Prishtinës, "Haxhi Zeka"në Pejë", "Kadri Zeka" në Gjilan. Vlen te potencohet se, ka udhëhequr afro 50 kandidat nw studimet e masterit dhe 3 kandidat për doctorate nw fushwn e shkencave juridike kushtetuese. Ka botuar tetë libra universitare dhe një monografi si dhe mbi 50 punime shkencore nw revista vendore, regjionale dhe ndwrkombwtare.

Për kontribut akademik në Fakultetin Juridik, Rektori i Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjilan ka dhënë: Mirwnjohje. Gjithashtu ka merr pjesë në simpoziumet dhe konferenca të ndryshme profesionale-shkencore në Kosovë dhe jashtë saj. Pas përfundimit të luftës 1999, ka qenë i angazhuar në QPK, përkatësisht në Ministrinë e Drejtësisë në cilësin e Drejtorit të Drejtoratit për Legjislacion, pastaj bashkëdrejtues i Departamentit të Pushtetit Lokal të KPA. Ka qenë i angazhuar në Kabinetin e Ministrisë për Tregti dhe Industri në cilësin e Këshilltarit Politik, përkatësisht në Kabinetin e Kryeministrit të Kosovës.

**Prof.ass.dr. Fejzullah Hasani:** ka kryer studimet themelor enë universitetin e Prishtinë. Po ashtu studimet e magjistraturës dhe doktoratës në Universitetin e Prishtinës në fushën juridike penale. Karrierën profesionale e ka filluar në gjykatën themelore. Duke treguar profesionalizëm të lartë është avansuar në Gjykatën e lartë duke u zgjedhur një mandat ( 7 vjet) zëvendës kryetar i Gjykatës Supreme dhe 7 vjet kryetar i Gjykatës Supreme. Ka një përvoj 15 vjecare akademike. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore vendore, regjionale dhe ndërkombëtare. Ka publikuar disa punime shkencore me recension ndërkombëtar. Ka



marrë pjesë në hartimin e komentareve nga fusha penale. Ka qene hartues i projektit për provimin e jurisprudencës. Ka qenë kryetar i Komisionit për Provimn e Jurisprudencës në Republikën e Kosovës. Ka hartuar 2 tekste universitare dhe 2 monografi.

**Prof.ass.dr. Dukagjin Leka:** Ka kryer studimet themelore në Fakultetin Juridik në Prishtinë dhe Fakultetin Filozofik – Shkenca Politike; studimet e masterit në departamentin e të drejtës ndërkombëtare në Prishtinë, ndërsa doktoratën në fushën Shkenca Juridike- Ndërkombëtare ne Universitetin e Tiranës. Ka një përvojë prej një dekadë e gjysmë si ekspert në organizata ndërkombëtare dhe ka nje karrier te gjate te punës ne misionet nderkombetare si UNMIK dhe EULEX. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore me karakter vendor, regional dhe ndërkombëtar si dhe ka publikuar 7 punime shkencore në revista shkencore me impact factor. Ka publikuar një monografi shkencore nga fusha juridike ndërkombëtare. Ka realizuar disa projekte shkencore me karakter ndërkombëtar. Karriera e tij profesionale me trajnime të ndryshme është mjaft e bujshme, duke përmendur sidomos ato nëpër vende si ShBA-ja dhe vendet e Unionit Evropian. Gjithashtu, ka marrë pjesë në shumë konferenca shkencore rajonale dhe ndërkombëtare, duke vazhduar edhe më tutje me konsolidimin e tij në aspektin profesional e poashtu edhe shkencor. Ai tani ka publikuar disa artikuj shkencorë, kryesisht nga lëmia juridike, politike ndërkombëtare dhe sociale, ku një punim i tij është i indeksuar në Web of Science, katër punime në Scopus dhe disa punime tjera të indeksuara në platformat e tjera ndërkombëtare. Ai, ka qenë i angazhuar në disa universitete në Kosovë si ligjërues, si në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, dhe në Kolegjin AAB. Ai është njohës shumë i mirë i gjuhës Angleze dhe Serbo-Kroate dhe ka njohuri bazike të Gjuhës Frënge.

**Prof.ass.dr. Urtak Hamiti,** ka kryer studimet në Prishtinë, ndërsa studimet e doktoratës në Universitetin e Tiranës ku mori titullin: Doktor i Historisë dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Ka punuar kabinetin e Kryeministrit të Kosovës si Këshilltar Politik, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, si Drejtor për NATO dhe OSBE, dhe ka qenë diplomat i lartë i Kosovës në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Kroaci. Është ekspert në fushën e marrëdhënieve diplomatike dhe të politikës së jashtme amerikane. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore, vendore dhe ndërkombëtare, si dhe ka publikuar punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare me impact faktor. Po ashtu, ka marr pjesë ne mbrojtjen e programeve për çështjeve te akreditimit (AAK) në Universitetin e Gjilanit.

**Prof.ass.dr. Albulena Hajdari;** ka kryer studimet themelore në Fakultetin Juridik në Prishtinë, Masterin në drejtimin penal juridik në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ndërsa studimet e doktoratës në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë, duke fituar titullin doktor i shkencave juridike penale. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare si dhe ka publikuar punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare me impact faktor. Është bashkë autore e një monografie shkencore. Ligjëron lëndët juridiko



penale.

**Prof.ass.dr. Liridon Dalipi;** ka kryer Fakultetin Juridik në universitetin e Tetovës; Magjistër i shkencave - Strategjia Mediale- Mediat dhe Zgjedhjet. Doktoratën e ka për funduar në universitetin e Sofjes në Studime Bibliotekare dhe Teknologjia e Informacionit, ku mori titullin: doktor në fushën administrative, biznes dhe komunikime shoqërore përmes teknologjisë. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare si dhe ka publikuar punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare me impact faktor.

**Prof.ass.dr. Fadil Osamni;** ka kryer studimet themelore në Universitetin e Prishtinës Fakultetin Ekonomik duke i vazhduar studimet e masterit në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë, fusha e Menaxhmentit, ndërsa, studimet e doktoratës i kreu në Universitetin i Tiranës në fushën e Ekonomisë, për Politika dhe Qeverisje në Evropë me temën: Integrimi në BE - Sfidë e Kosovës (aspekti Ekonomik, Politik dhe Juridik). Ka publikuar një monografi shkencore. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare si dhe ka publikuar punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare me impact faktor.

Gjithashtu, ka një pervoj relativisht të mirë në disa universitete në Kosovë si ligjërues, si: në Universitetin e Biznesit në Gjakovë, Kolegjin “Globus” në Prishtinë dhe në Kolegjin AAB në Prishtinë dhe Ferizaj, si dhe ka mentoruar disa kandidat në studime master dhe Bashqelor, në këto Universitete.

Karriera e tij profesionale është edhe e, zv.Kryetar i Keshillit Drejtues (bordit) të UP-se “Hasan Prishtina” në Prishtinë dhe tani staf i i rregullt akademik, në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjiilan.

**Ass.Dr. Fatmire Krasniqi;** studimet themelore i ka kryer në Fakultetin Juridik po ashtu studimet e masterit në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës në drejtimin penal juridik me notë mesatare 10.00. Studimet e doktoratës në Fakultetin Juridik në Prishtinë në katedrën penale, ku mori titullin: Doktor i shkencave juridike - penale. Ka publikuar një monografi shkencore. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare si dhe ka publikuar punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare me impact faktor. Është asistente e lëndëve juridike penale.

**Ass.Dr. Selim Daku:** Ka kryer Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës, studimet e masterit në Universitetin e Evropës Juglindore në fushën e diplomacisë, ndërsa studimet e doktoratës në Fakultetin e Shkencave Politike, në Universitetin e Evropës Juglindore. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare; ka publikuar punime shkencore në revista shkencore vendore dhe ndërkombëtare me impact faktor. Merr pjesë në projekte hulumtuese ndërkombëtare. Është asistent i lëndëve juridike ndërkombëtare.

**Ass. PhD (c) Detrinë Alishani;** ka kryer studimet themelore në Universitetin e Prishtinës në dy fakultete, në Fakultetin Juridik dhe në Fakultetin Ekonomik. Studimet e masterit i ka përfunduar në Fakultetin Juridik drejtimi juridik civil. Ka marrë pjesë në konferenca



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



---

shkencore vendore dhe ndërkombëtare; ka publikuar punime shkencore në revista shkencore vendore dhe ndërkombëtare me impact faktor. Është në përfundim të studimeve të doktoratës në fushën Juridiko-Civile. Aktualisht është asistente e lëndëve juridike civile.



<b>PERSONELI I RREGULLT AKADEMIK</b>						
	Emri	Mbiemri	Grada shkencore	Grada akademike	Fusha e studimit	Kohëzgjatja e Kontratave
1	Sadik	Haxhiu	Dr. sc	Prof. asoc.	Shkenca juridike – fusha kushtetuese administrative	4 vite
2	Fejzulla	Berisha	Dr.sc.	Prof. asoc.	Shkenca juridike – fusha kushtetuese administrative	4 vite
3	Fejzullah	Hasani	Dr. sc	Prof. ass.	Shkenca juridike - fusha penale	4 vite
4	Dukagjin	Leka	Dr. sc.	Prof.ass.	Shkenca juridike – fusha studime evropiane dhe legjislacion	4 vite
5	Albulena	Hajdari	Dr. sc.	Prof. ass.	Shkenca juridike – fusha penale	4 vite
6	Urtak	Hamiti	Dr. sc.	Prof. ass.	Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci	4 vite
7	Liridon	Dalipi	Dr. sc.	Prof. ass.	Fusha Administrative, biznes dhe komunikime shoqërore përmes teknologjisë	4 vite
8	Fadil	Osmani	Dr.Sc	Prof. ass.	Integrimi në BE - Sfidë e Kosovës - aspekti ekonomik, politik dhe juridik	4 vite
9	Fatmire	Krasniqi	Dr. sc.	Ass. dr.	Shkenca juridike – fusha penale	3 vite
10	Selim	Daku	Dr. sc.	Ass.dr.	Shkenca politike	3 vite
11	Detrinë	Alishani	PhD.c	Ass.	Shkenca Juridike – fusha civile	3 vite

Në tabelën e mësipërme është profesorati në marrëdhënie të rregullt pune. Shumica e tyre kanë përvojë akademike të gjatë dhe të suksesshme nëpër universitetet publike brenda Kosovës dhe jashtë saj. Përveç që janë të angazhuar në studimet themelore, ata janë edhe të angazhuar në dy programet e studimeve të masterit, varësisht prej profilit të tyre.

Duke pasur parasysh se jemi në fazën e konsolidimit të Fakultetit Juridik, konform akteve normative në fuqi, si Statutit të Universitetit dhe Rregullores për zgjedhjen e personelit të



rregullt akademik, në çdo vit akademik jemi duke rekrutuar personel të rregullt akademik. Së pari Këshilli i Fakultetit identifikon nevojat për personel të rregullt akademik, asistent apo profesor; debatohet në Këshillin mësimor shkencor dhe i njëjti aprovohet, me pastaj me një arsyetim të bazuar siç janë fondi i orëve që duhet të plotësohet dhe qëndrueshmëria financiare, pastaj i bënë kërkesë Senatit të Universitetit për miratim. Pas miratimit nga ana e Senatit të Universitetit, Rektori i Universitetit bënë shpalljen publike për rekrutimin e profesorëve/asistentëve të rregullt. Në konkurs duhet të specifikohen në mënyrë detale kushtet që duhet t'i plotësoj një kandidat për t'u zgjedhur profesor i rregullt në universitet siç janë: kualifikimet profesionale deri te thirrja shkencore doktor i shkencave, pjesëmarrje në konferenca shkencore, vendore dhe ndërkombëtare; Punimet shkencore me impakt factor (konform UA MASHT, nr.01/2018) si dhe kontributet tjera akademike dhe profesionale. Konkursi është i hapur dhe ai publikohet nëpërmjet mjeteve të informimit publik, duke i'u mundësuar kandidatëve një konkurrencë të barabartë qoftë për personelin e brendshëm apo të jashtëm.

Këshilli i fakultetit pas shpalljes së konkursit publik, propozon Komisionin Recensues prej tre profesorëve të cilët duhet të kenë thirrje relevante akademike. Komisioni Recensues pasi shqyrton dokumentacionin e kandidatëve konkurrues, ata kandidatë që i plotësojnë kushtet formale juridike, me pastaj i fton në intervistë. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni Recensues i harton raportet për secilin kandidat dhe pastaj përmes Zyrës së Personelit e shpallë rezultatin e kandidateve në buletin, në në Eëb faqe të Universitetit. Pas përfundimit të ekspozimit të recensioneve përmes buletinit në Eëb faqe, Këshilli i Fakultetit, raportet recensuese u'a dërgon Komisionit të Studimeve të Universitetit. Komisioni i Studimeve ka për detyrë të vlerësoj përmbajtjen, ligjshmërinë, objektivitetin e punës së Komisionit Recensues si dhe vlerësimin e kontributeve shkencore dhe profesionale të kandidatëve konkurrent. Komisioni i Studimeve bënë një raport të vlerësimit të kandidatëve dhe ja dërgon Senatit për shqyrtim dhe miratim. Senati pastaj pas debatit profesional merr vendim për zgjedhjen/moszgjedhjen e kandidatit për profesor ose asistent. Pas votimit në Senat, emërimi i profesorit/asistentit, të zgjedhur bëhet për periudhën 4 vjeçare; asistentët për periudhën 3 vjeçare ndërsa ligjëruesit për periudhën 3 vjeçare. (Aktualisht Fakulteti juridik është duke zhvilluar procedurat e Rekrutimit për 3 pozita për staf të rregullt Akademik (profesorë) për vitin akademik 2020-2021 ( është në procedurë të recensionimit). Më gjerësisht shih: (*Shtojca nr. 1. e Rregullores për zgjedhjen e stafit të rregullt akademik. Ref.01/315, datë, 18/03/2019*).





## Analiza SWOT për stafin akademik:

*(Ju lutemi shënoni perspektivën tuaj mbi pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe sfidat në lidhje me operacionet institucionale. Këto mund t'i referohen faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë përformancën institucionale kundrejt standardeve dhe treguesve të përformancës së përfshira në këtë fushë të përgjithshme, siç përcaktohet në manualin e Akreditimit të AKA-së).*

### A. Pikat e forta

- Stafi akademik i fakultetit ka një përgatitje të kënaqshme profesionale, ku i ligjërojnë mbi 80 % të lëndëve të programit Juridik i Përgjithshëm.
- Profesionalizmi i stafit akademik dhe përvoja e tyre e më hershme në institucione akademike dhe institucione relevante shtetërore dhe të drejtësisë si në: Gjykata, prokurori, qeveri, parlament, institucione të pavarura shtetërore etj.,
- Cilësia dhe disiplina në nivel të lartë e profesorëve dhe asistentëve në ligjërata dhe ushtrime.
- Një numër i profesorëve janë hartues të teksteve universitare, ku tekstet e tyre janë obligative jo vetëm në universitetin “Kadri Zeka” por edhe në universitete tjera në Kosovë, në Shqipëri dhe Maqedoni.
- Përkrahja dhe bashkëpunimi i ngushtë në mes menaxhmentit të UKZ dhe Fakultetit Juridik në realizimin e synimeve të fakultetit për: organizimin e tryezave shkencore, vizitave të institucioneve profesionale si: gjykatave, prokurorive, parlamentit, qeverisë, fakulteteve simotra në Kosovë dhe jashtë saj si dhe vizitave studimore të studentëve tanë në Universitetin e Evropës Juglindore, në universitetin e Mariborit, në universitetin e Zug-ut, etj.,
- Përvoja e bartësve të programit në fushën administrative kushtetuese, të drejtës ndërkombëtare dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, fushës penale etj.,
- Rezultatet e studentëve nga rajoni i Gjilanit në studime në universitetet e njohura botërore Split Kroaci, Ajoëa SHBA, Zug Zvicër, UEJL Tetovë, Gjermani.

### B. Dobësitë

- Mungesa e stafit të mjaftueshëm mbështetës administrativ i cili do të na lehtësojë në kryerjen e obligimeve të shërbimeve administrative.
- Infrastruktura e pamjaftueshme hapësinore për stafin akademik, administrativ dhe procedurat e komplikuar që vijnë nga qeveria, për zgjidhjen e tyre.
- Procedurat e vështirësuar administrative në zgjedhjen e stafit të ri akademik që zgjasin me muaj, të përcaktuara me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe udhëzimet



administrative të MASHT si dhe Statutin e Përkohshëm të UKZ-së i miratuar nga MASHT.

- Procedurat e vështira administrative në zhvillimin e aktiviteteve të shkëmbimit të personelit akademik ndërkombëtar, furnizimit me literaturë, revista shkencore dhe të ngjashme.

### C. Mundësitë

- Intensifikimi i hulumtimeve shkencore nga fusha e shkencave juridike në Kosovë dhe inkorporimi i tyre në rrjedhat e hulumtimeve evropiane.
- Krijimi i mundësive për hulumtues të rinj që studiojnë në fushën e shkencave juridike të kontribuojnë në UKZ.
- Përvoja e gjatë e disa prej profesorëve për hartimin dhe avancimin e kurrikulës së fakultetit.

### D. Sfidat

- Ballafaqimi i UKZ me sfida, jenë të shkaktuara nga faktorë të ndryshëm, si:
- Interesimi jo i mjaftueshëm i nxënësve elitar për të studiuar në këtë program;
- Mospërkrahja institucionale nga ana e MASHT-it për krijimin e kushteve të punës dhe projekteve që kanë kosto financiare etj.

Varësisht nga sfidat e paraqitura dhe të identifikuar, do të ndërmerren masat respektive për tejkalimin e tyre.



## 2.5. Përmbajtja e procesit arsimor

(Ju lutemi jepni vetëvlerësimin e performancës tuaj ndaj secilit prej standardeve dhe treguesve të performancës të përfshira në këtë fushë të përgjithshme, siç përcaktohet në manualin e Akreditimit të AKA-se)

### Përshkrimi i programit të studimit (emri, orët javore, ECTS kreditë dhe statusi)

Viti i parë - Programi Juridik i Përgjithshëm					
	Emri i lëndës	Orë/javë	ECTS	Oblig/Zgjedhje	Mësimdhënësi
Semestri I					
1	O - Fillet e së drejtës	3+1	6	O	Prof. Asoc. Dr. Fejzulla Berisha
2	O - Teoria dhe praktika parlamentare	2+1	5	O	Prof. Asoc. Dr. Sadik Haxhiu
3	O – Ekonomia	2+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Fadil Osmani
4	O - Gjuhë e huaj angleze ose Gjuhë e huaj gjermane	2+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Shpresa Qamili Prof. Ass. Dr. Milote Sadiku
5	O - Historia e institucioneve shtetërore dhe juridike	2+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Urtak Hamiti
6	Z - Konsumi dhe e drejta e konsumatorëve	2+1	4	Z	Prof. Ass. Dr. Fadil Osmani
7	Z - Sociologjia juridike	2+1	4	Z	Prof. Ass. Dr. Urtak Hamiti
8	Z - Hyrje në Marrëdhëniet Ndërkombëtare	2+1	4	Z	Dr. Sc. Selim Daku
9	Z - Hyrje në Drejtën Civile	2+1	4	Z	Dr. Sc. Burim Tahiri
Semestri II					
1	O - E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut	3+1	6	O	Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka
2	O - Sistemi gjyqësor dhe profesionet e lira në Republikën e Kosovës	2+1	5	O	Prof. Asoc. Dr. Sadik Haxhiu
3	O - Gjuhë e huaj angleze ose Gjuhë e huaj gjermane	2+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Shpresa Qamili Prof. Ass. Dr. Milote Sadiku



4	O - Historia e shtetit dhe e së drejtës shqiptare	2+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Urtak Hamiti
5	O - Integrimet Ekonomike Evropiane	2+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Fadil Osmani
6	Z - E Drejta Romake	2+1	4	Z	Dr. Sc. Ardian Emini
7	Z - Komunikimi Masiv, e drejta dhe Politikat	2+1	4	Z	Prof. Ass. Dr. Urtak Hamiti
8	Z - Hyrje në të drejtën Penale	2+1	4	Z	Dr. Sc. Fatmire Krasniqi
9	Z - Histori e Diplomacisë	2+1	4	Z	Prof. Ass. Dr. Urtak Hamiti

Viti i dytë - Programi Juridik i Përgjithshëm					
Nr.r	Emri i lëndës	Orë/javë	ECTS	Oblig/Zgj.	Mësimdhënësi
Semestri III					
1	O - E drejta kushtetuese	3+1	6	O	Prof. Ass. Dr. Sadik Haxhiu
2	O - E drejta penale	3+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Fejzullah Hasani
3	O - E drejta Civile	3+1	5	O	Dr. Sc. Burim Tahiri
4	O - Organizatat ndërkombëtare	2+1	5	O	Dr. Sc. Selim Daku
5	O - Politika ekonomike	2+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Fadil Osmani
6	Z - Qeverisja Lokale	2+1	4	Z	Prof. Ass. Dr. Liridon Dalipi
7	Z - E drejta Ndërkombëtare e Pakicave	2+1	4	Z	Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka
8	Z - E drejta e Autorit	2+1	4	Z	Prof. Ass. Dr. Muharrem Faiku
9	Z - Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në fushën penale	2+1	4	Z	Dr. Sc. Fatmire Krasniqi
Semestri IV					
1	O - E drejta administrative	3+1	6	O	Prof. Asoc. Dr. Sadik Haxhiu



2	O - E drejta familjare dhe trashëgimore	2+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Muharrem Faiku
3	O – Kriminalistika	2+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Albulena Hajdari
4	O - Metodologjia e hulumtimit shkencor	2+1	5	O	Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi
5	O - E drejta e krahasuar	2+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka
6	Z – E drejta e Kadastrit	2+1	4	Z	Dr. Sc. Burim Tahiri
7	Z - Gjyqësia kushtetuese	2+1	4	Z	Prof. Asoc. Dr. Fejzulla Berisha
8	Z - Shkathësitë praktike gjyqësore	2+1	4	Z	Dr. Sc. Fatmire Krasniqi
9	Z - Krimi i Organizuar	2+1	4	Z	Dr. Sc. Fatmire Krasniqi

Viti i tretë - Programi Juridik i Përgjithshëm					
	Emri i lëndës	Orë/javë	ECTS	Oblig/Zgj.	Mësimdhënësi
Semestri V					
1	O - E drejta ndërkombëtare publike	3+1	6	O	Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka
2	O - E drejta financiare	3+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Fadil Osmani
3	O - E drejta e Unionit evropian	3+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka
4	O - Procedura administrative	3+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Liridon Dalipi
5	O - E drejta tregtare	3+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Fadil Osmani
6	Z - Politika Kriminale	2+1	4	Z	Prof. Ass. Dr. Albulena Hajdari
7	Z - E drejta e traktateve Ndërkombëtare	2+1	4	Z	Prof. Ass. Dr. Urtak Hamiti
8	Z - E drejta e Sigurimeve	2+1	4	Z	Prof. Ass. Dr. Muharrem Faiku



9	Z - Sistemi Politik i Kosovës	2+1	4	Z	Dr. Sc. Selim Daku
<b>Semestri VI</b>					
1	O - E drejta e punës dhe sigurimet sociale	3+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Liridon Dalipi
2	O - E drejta e procedurës penale	3+1	6	O	Prof. Ass. Dr. Fejzullah Hasani
3	O - E drejta ndërkombëtare private	3+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka
4	O - E drejta detyrimore	2+1	5	O	Dr. Sc. Burim Tahiri
5	O - Klinika juridike penale	3+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Fejzullah Hasani
6	Z - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare	2+1	4	Z	Dr. Sc. Selim Daku
7	Z - Krimet dhe siguria kibernetike	2+1	4	Z	Dr. Sc. Fatmire Krasniqi
8	Z - Etika ligjore dhe profesionale	2+1	4	Z	Prof. Ass. Dr. Liridon Dalipi
9	Z - Psikologjia Gjyqësore	2+1	4	Z	Dr. Sc. Fatmire Krasniqi

#### Viti i katërt - Programi Juridik i Përgjithshëm

	Emri i lëndës	Orë/javë	ECTS	Oblig/ Zgj.	Mësimdhënësi
<b>Semestri VII</b>					
1	O - E drejta e procedurës civile	3+1	6	O	Prof. Ass. Dr. Muharrem Faiku
2	O - Klinika juridike administrative	3+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Liridon Dalipi
3	O - Kriminologji me penologji	2+1	5	O	Dr. Sc. Fatmire Krasniqi
4	O - Klinika juridike Civile	3+1	5	O	Prof. Dr. Adnan Jashari
5	O-Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të	3+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka



	drejtat e njeriut				
6	z- Politika e Jashtme e BE-se	2+1	4	Z	Dr. Sc. Selim Daku
7	Z - Mjekësia ligjore	2+1	4	Z	Dr. Sc. Fatmire Krasniqi
8	Z - Përgjegjësia penale e personave juridikë	2+1	4	Z	Prof. Ass. Dr. Fejzullah Hasani
9	Z- E drejta e Arbitrazhit ne Kosove	2+1	4	Z	Dr. Sc. Burim Tahiri
<b>Semestri VIII - Moduli: E drejta kushtetuese dhe administrative</b>					
1	O - E drejta kushtetuese pozitive	3+1	6	O	Prof. Asoc. Dr. Fejzulla Berisha
2	O - E drejta administrative-pjesa e posaçme	3+1	6	O	Prof. Asoc. Dr. Fejzulla Berisha
3	O - Sistemet elektorale	3+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Liridon Dalipi
4	O - Administrata Publike	3+1	5	O	Dr. Sc. Selim Daku
5	O - Praktika Profesionale	5+1	8	O	Prof. Ass. Dr. Sadik Haxhiu

<b>Semestri VIII - Moduli: E drejta penale</b>					
1	O - E drejta penale - pjesa e posaçme	3+1	6	O	Prof. Ass. Dr. Fejzullah Hasani
2	O - E drejta e procedurës penale – pjesa e posaçme	3+1	6	O	Prof. Ass. Dr. Fejzullah Hasani
3	O – Viktimologjia	3+1	5	O	Prof. Ass. Dr. Albulena Hajdari
4	O - E drejta penale ndërkombëtare	3+1	5	O	Dr. Sc. Fatmire Krasniqi
5	O - Praktika Profesionale	5+1	8	O	Prof. Ass. Dr. Fejzullah Hasani



